

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6353
E premte, 2 korrik 2021
çmimi 0.40 €

Diaspora nuk do ta paguajë sigurimin kufitar për vetura

FAQE 8



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ENVER HOXHA, TETË MUAJ PASI E DREJTOI PARTINË DEMOKRATIKE TË KOSOVËS (PDK), KONFIRMOI TË ENJTEN SE NUK DO T'I HYJË GARËS PËR KRYETAR TË PDK-së

FAQE 2

HOXHAI: GJENERATA E RE MUND TA BËJË NDRYSHIMIN NË PDK DHE TA UDHËHEQË BETEJËN PËR LARGIMIN E KURTIT



Anëtari i Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka vendosur që të mos kandidojë për kryetar të partisë. Këtë qëndrim Hoxhaj e bëri me dije në një konferencë për media mbajtur të enjten. Ai ka thënë se nuk po ik nga përgjegjësia, por se mendon që ky vendim do t'i kontribuojë unitetit në parti.

"Gjenerata e re mund ta bëjë ndryshimin në Partinë Demokratike të Kosovës", ka thënë Hoxhaj. Ai ka treguar se PDK-ja ka nevojë të hapet si parti, të reflektojë për ndryshimet në vend dhe ta udhëheqë betejën për demaskimin dhe largimin e Albin Kurtit nga pushteti

AKTUALE



PALMERI KËRKON QË TË HIQEN VIZAT PËR KOSOVËN F. 5

GLPS-ja: NË KËTË 100-DITËSH MË SHUMË KA PASUR PREMTIME SESA REZULTATE TË PREKSHME F. 7

DIPLOMONI GJENERATA 2021 E KADETËVE TË FSK-së F. 6



EKONOMI



SHMANGIA E DETYRIMEVE TATIMORE, ATK-ja NIS AKTIVITETET INTENSIVE F. 8

OAK-u KUNDËR MORATORIUMIT TË PROPOZUAR NGA MINISTRI ALIU PËR GURTHYESIT F. 8

SPORT



SONTE ZVICËR - SPANJË DHE BELGIKË - ITALI F. 19



STOLTENBERGU SHPREH PËRKUSHTIMIN E NATO-s PËR MJEDIS TË QETË NË KOSOVË

FAQE 3



FILLOJNË PATRULLIMET E PËRBASHKËTA NË MES TË POLICISË SË KOSOVËS DHE POLICISË SË SHQIPËRISË FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçishtë-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

ENVER HOXHA, TETË MUAJ PASI E DREJTOI PARTINË DEMOKRATIKE TË KOSOVËS (PDK), KONFIRMOI TË ENJTEN SE NUK DO T'I HYJË GARËS PËR KRYETAR TË PDK-SË

Hoxhaj: Gjenerata e re mund ta bëjë ndryshimin në PDK dhe ta udhëheqë betejën për largimin e Kurtit

Anëtari i Kryesisë i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka vendosur që të mos kandidojë për kryetar të partisë. Këtë qëndrim Hoxhaj e bëri me dije në një konferencë për media mbajtur të enjten. Ai ka thënë se nuk po ik nga përgjegjësia, por se mendon që ky vendim do t'i kontribuojë unitetit në parti. "Gjenerata e re mund ta bëjë ndryshimin në Partinë Demokratike të Kosovës", ka thënë Hoxhaj. Ai ka treguar se PDK-ja ka nevojë të hapet si parti, të reflektojë për ndryshimet në vend dhe ta udhëheqë betejën për demaskimin dhe largimin e Albin Kurtit nga pushteti



fituese. PDK-ja është partia më reformatore në Kosovë. Gjithmonë ka ditur ta gjejë rrugën përpara, të ripërtërihet me njerëz dhe kapacitete të reja" ka thënë Hoxhaj.

Ai ka falënderuar të gjitha strukturat partiake për mbështetjen duke thënë se ishte pjesë e fitoreve madhështore të PDK-së, por pati edhe fatin që ta udhëheqë në çastet më kritike të ekzistencës së saj. "E kam marrë udhëheqjen e përkohshme të PDK-së në një moment të vështirë si për vendin tonë, ashtu edhe për vetë PDK-në. Qëllimi im ka qenë që PDK-ja të bëhet gati për t'u përballur me sfidat që sjell qeverisja autoritare dhe izolacioniste e Albin Kurtit. Partia Demokratike e Kosovës e ka trashëgiminë nga lufta çlirimtare, pavarësimin e vendit dhe shtetndërtimin. Këto shtylla të PDK-së e vendosin partinë tonë si bartëse të betejës politike ndaj Kurtit dhe Vetëvendosjes, të cilët nuk e kanë asnjë trashëgimi në rrugëtimin e Kosovës. Përkundrazi, kanë qenë pengesë dhe bllokuese të vendit", ka thënë Hoxhaj. PDK-ja më 3 korrik do të mbajë konventën për zgjedhjen e liderit të ri. Deri të premtën vetëm Memli Krasniqi është kandidat për kryetar të partisë.

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 1 KORRIK - Enver Hoxhaj në një konferencë për media mbajtur të enjten ka konfirmuar se nuk do të kandidojë për kryetar të Partisë Demokratike të Kosovës. "Me PDK-në kam rrugëtimin në çastet më të mira të saj, në fitoret madhështore, por ishte edhe fati im që ta udhëheq në çastet më kritike të ekzistencës së saj. Që nga këto zgjedhje e deri më sot kam punuar me energjitë e fundit; kam punuar me shpirt për PDK-në, për Hashim Thaçin, për Kadri Veselin, për elektoratin e PDK-së. Një Kosovë më e mirë është ambicia ime e përhershme. Unë

nuk jam kandidat për kryetar të partisë. Nuk është ikje nga gara, as nga përgjegjësia, as nga puna dhe përkushtimi. Vendimi im sot është në vijë me vendimet e mia që gjithmonë i kam marrë në PDK. Ky vendim është në të mirë të PDK-së", ka thënë ai, duke shtuar se gjenerata e re mund ta bëjë ndryshimin në PDK ndërsa, siç ka thënë Hoxhaj, "detyra jonë është që ta mbështesim lidhshimin e ri".

Po ashtu, Hoxhaj ka shtuar se beson që PDK-ja ka nevojë të hapet si parti, të reflektojë për ndryshimet në vend dhe ta udhëheqë betejën për demaskimin dhe largimin e Albin Kurtit nga pushteti. "Sot ne kemi njëherë prej qeverive më të rrezikshme në vend. Qeveri e

cila ka synim ta kthejë mbrapshtë çdo të arritur të këtij vendi, ta izolojë shtetin tonë dhe të vendosë një sundim autoritar. Prandaj nuk duhet të heshtim. PDK-ja duhet t'i mbrojë arritjet e këtij vendi që janë arritje edhe të qytetarëve të Kosovës. Nga e shtuna, PDK-ja

e hap një kapitull të ri. Ky kapitull duhet ta shënojë rikthimin e PDK-së dhe ta trasojë vizionin për të ardhmen e partisë dhe të vendit. Krejt përvojën, dijen dhe përkushtimin do t'ia dedikojë forcimit, konsolidimit dhe rikthimit të PDK-së si parti

Pak mundësi për sukses në Ballkanin Perëndimor nga presidenca sllovene e BE-së

LUBJANA, 1 KORRIK- Slovenia të enjten ka marrë kryesimin e radhës të Këshillit të Bashkimit Evropian që në gjysmën e parë të vitit e ka pasur Portugalia. Mes prioriteteve, Slovenia ka veçuar edhe avancimin e Ballkanit Perëndimor në procesin e integriteteve evropiane. Për këtë qëllim, Slovenia ka caktuar edhe zhvillimin e një samiti të veçantë të BE-së me Ballkanin Perëndimor. Në Bruksel diplomatët presin që Slovenia të bëjë përpjekje serioze në këtë drejtim, por tërheqin vërejtjen se nuk varet gjithçka nga puna e kryesuesit të radhës, pasi për marrjen e vendimeve duhet pajtimi edhe i vendeve të tjera të BE-së.

Si sukses i presidencës sllovene



në raport me Ballkanin Perëndimor do të konsiderohej sikur deri në fund të vitit të nisin negociatat e anëtarësimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut dhe që Kosovës t'i ofrohet liberalizimi i vizave.

Në shikim të parë këto çështje

nuk duken aq të vështira pasi Komisioni Evropian ka përsëritur se të tria këto shtete i kanë përmbushur të gjitha kushtet. Por, në rastin e nisjes së negociatave të anëtarësimit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë, pengesat janë

paraqitur pikërisht në Këshill. Bullgaria vazhdon ta bllokojë miratimin e kornizës negociuese për Maqedoninë e Veriut dhe disa shtete të tjera për këtë arsye nuk duan që Shqipëria të ndahet nga paketa dhe të nisen negociatat vetëm me Tiranën. Pasi në Bullgari së shpejti zhvillohen zgjedhjet e jashtëzakonshme, do të pritet që pas këtyre zgjedhjeve të punohet për arritjen e konsensusit në Këshillin e BE-së dhe Slovenia ka paralajmëruar se do të punojë në këtë drejtim.

Sa i takon liberalizimit të vizave për Kosovën, edhe këtu Komisioni Evropian ka përsëritur qëndrimin që nga viti 2018 se janë përmbushur të gjitha kushtet. Këtë e ka

mbështetur edhe Parlamenti Evropian, por çështja ka ngecur në Këshillin e BE-së. Disa shtetet anëtare, e më së shumti përmendet Franca, nuk mbështesin liberalizimin e vizave për Kosovën, prandaj edhe kjo çështje vazhdon të mbetet e bllokuar.

Përpjekjet e Gjermanisë, vitin e kaluar, dhe të Portugalisë në pjesën e parë të këtij viti, nuk kishin rezultuar me sukses as në rastin e nisjes së negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut e as rreth liberalizimit të vizave me Kosovën. Nëse Slovenia nuk do të arrijë t'i sigurojë vendimet për këto tema, atëherë gjithçka do të bartet për vitin që vjen kur kryesimin e radhës do ta ketë Franca.

Stoltenbergu shpreh përkushtimin e NATO-s për mjedis të qetë në Kosovë

PRISHTINË, 1 KORRIK (ER) - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të enjten në takim sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, i cili ka qëndruar për vizitë në Kosovë.

Osmani e ka falënderuar Stoltenbergun për rolin vendimtar të Aleancës Veri-Atlantike në lirinë e Kosovës, por edhe për kontributin e tashëm për një ambient të qetë e të sigurt nëpërmjet trupave të KFOR-it. Në këtë takim, presidentja Osmani ka falënderuar Stoltenbergun edhe për mbështetjen e KFOR-it për trajnimin e FSK-së, e cila procesin e tranzicionit në ushtri po e kryen konform standardeve të NATO-s, duke qenë e denjë për t'u bërë pjesë e kësaj organizate.

Osmani ka përmendur edhe mbështetjen e KFOR-it dhënë komunave në përballje me pandeminë Covid-19.

Më tej, presidentja Osmani ka potencuar se e ardhmja e Kosovës është në BE, NATO

dhe OKB. "Ne po punojmë me përkushtim që të anëtarësohemi në NATO. Kemi nevojë për mbështetjen e kësaj organizate edhe me anëtarët e NATO-s, të cilët nuk e njohin Kosovën", ka theksuar presidentja Osmani.

Ndërkaq në kontekstin e sigurisë rajonale, presidentja ka përmendur edhe rrezikun nga ndikimi rus në Ballkan, ndaj e ka konsideruar anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë tejet të rëndësishëm.

Roli i NATO-s në Kosovë dhe bashkëpunimi me institucionet për sigurinë në vend u diskutuan në takimin në mes të kryeministrit të Republikës së Kosovës, Albin Kurti, dhe sekretarit të përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg.

Kurti shprehu mirënjohjen e popullit dhe të Qeverisë së Kosovës për kontributin e çmuar të NATO-s në Kosovë dhe rëndësinë e KFOR-it për siguri dhe stabilitet në rajon. Ai ritheksoi përkushtimin e



Kosovës për integrim në aleancën më të madhe të paqes e të sigurisë në botë, NATO.

Kryeministri Kurti e njoftoi sekretarin e NATO-s për përmirësimin e situatës me

pandeminë Covid-19 si rezultat i menaxhimit të mirë institucional dhe për reformat e nisura në drejtësi dhe punësim.

Sekretari Stoltenberg vlerësoi

angazhimin institucional për ta garantuar sigurinë në vend dhe shprehu përkushtimin e vazhdueshëm të misionit të NATO-s për mjedis të qetë dhe të sigurt në Kosovë.

Diplomon gjenerata 2021 e kadetëve të FSK-së

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 1 KORRIK- Në ambientet e kazermës "Adem Jashari" të enjten është mbajtur ceremonia ushtarake e diplomimit të kadetëve të Akademisë së Mbrojtjes së FSK-së, respektivisht Qendrës për Studime Universitare të gjeneratës 2021.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, morën pjesë ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, zëvendësministri i Mbrojtjes, Shemsi Sylja, komandanti i FSK-së, gjeneralletënant Rrahman Rama, stafi i lartë ushtarak dhe civil i Ministrisë së Mbrojtjes dhe SHP të FSK-së, atashe ushtarakë të vendeve partnere, oficerë të NALT-it, si dhe familjarë të kadetëve të diplomuar.

Pas ceremonisë së nderimit të flamurit, me fjalë përshëndetëse të pranishmëve u janë drejtuar nikoqirja e



ceremonisë, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), komandë brenda së cilës vepron edhe Akademia e Mbrojtjes dhe QSU, gjeneral brigade Irfete Spahiu.

Gjeneral Spahiu në adresimin e saj ua rikujtoi kadetëve rrugëtimin e përbashkët me të gjitha strukturat e komandës që udhëheq për ta realizuar arritjen e standardeve më të larta

profesionale dhe akademike me programin tejet sfidues për përgatitje psikike, fizike, profesionale dhe intelektuale. Nga ana e tij, komandanti i FSK-së, gjeneralletënant Rrahman

Rama, në mesazhin e tij drejtuar kadetëve të diplomuar, i inkurajoi të qëndrojnë konsistentë në realizimin e synimeve me frymën dhe shpirtin luftarak gjithmonë duke ruajtur prestigjin e FSK-së dhe vlerat themelore të ushtarakut, si: detyrën, nderin dhe atdheun. Ai, gjithashtu, ka shprehur falënderimin për partnerët tanë të cilët me mbështetjen e madhe mundësuan zhvillimin dhe avancimin e QSU-së.

Në emër të ministrit të Mbrojtjes, Armend Mehaj, në fjalën e tij zëvendësministri Sylja ua rikujtoi kadetëve rrugëtimin me përplot sprova e sfida gjatë studimeve.

Ceremonia përkatëse vazhdoi me ndarjen e diplomave për 15 kadetë të diplomuar nga ana e ministrit

Mehaj, zëvendësministri Sylja, gjeneral Ramës dhe gjeneral Spahiut. Në mesin e të diplomuarve ishin edhe dy kadetë nga Republika e Shqipërisë.

Specialja ua vazhdon paraburgimin Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit

PRISHTINË, 1 KORRIK (ER) - Gjykata Speciale ka marrë vendim për vazhdimin e masës së paraburgimit ndaj Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit. Sipas njoftimit, Specialja ka urdhëruar vazhdimin e masës së paraburgimit ndaj Jakup

Krasniqi, i cili mund t'i paraqesë parashtrës për shqyrtimin e tjetër të paraburgimit deri më 9 gusht të këtij viti ose deri më 19 gusht të këtij viti.

I njëjti vendim vlen edhe për Rexhep Selimin, i cili mund t'i paraqesë parashtrës për

shqyrtimin tjetër të masës së paraburgimit deri në datat e lartcekura. Në paraburgim në Hagë janë duke u mbajtur edhe Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Nasim Haradinaj, Hysni Gucati, Salih Mustafa dhe Pjetër Shala.





Palmeri kërkon që të hiqen vizat për Kosovën

“Është jetike që BE-ja ta mbështesë rajonin dhe ta miratojë liberalizimin e vizave për Kosovën. Jemi të zhgënjyer nga vendimi për të mos nisur negociatat”, ka deklaruar të enjten zëvendësi i ndihmëssekretarit amerikan të Shtetit, Matthew Palmer

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

OHËR, 1 KORRIK - Bashkëpunimi dhe raportet e mira ndërfaqësore është tema e dyditore ndërkombëtare “Prespa Forum” që ka nisur të enjten në Ohër, organizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Maqedonisë së Veriut. Në këtë forum po marrin pjesë përfaqësues të lartë shtetërorë nga Ballkani, Bashkimi Evropian dhe ShBA-ja, ndërsa tema e konferencës është “Ballkani Perëndimor: pjesa që i mungon Evropës që të jetë e

plotë”.

Në fjalimin e tij, zëvendësi i ndihmëssekretarit amerikan të Shtetit, Matthew Palmer, ka shprehur dëshpërimin që Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria nuk arriten të nisin negociatat e anëtarësimit me Bashkimin Evropian gjë që, sipas tij, mund të ketë rritur skepticizmin, por edhe mund ta minojë rolin e ShBA-së dhe Evropës në sigurinë dhe integrimin e rajonit. “Ne jemi të zhgënjyer që çështja e hapjes së konferencave të para ndërqeveritare për Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë nuk është zgjidhur pavarësisht prej

angazhimit të fortë dhe zgjidhjeve të arsyeshme të presidencës portugeze dhe partnerëve të fortë evropianë. Nëse ShBA-ja dhe BE-ja nuk tregojnë përkushtim ndaj rajonit, kjo çon në rritjen e skepticizmit në vetë rajonin dhe mundësinë që konkurrentët gjeopolitikë të minojnë në mënyrë agresive kredibilitetin e ShBA-së dhe të BE-së dhe vetë rajoni të dyshojë në përcaktimin për integrimin evropian”, ka deklaruar diplomati amerikan, duke theksuar më tej edhe çështjen e liberalizimit të vizave për Kosovën, premtim ky që, sipas tij, duhej të mbahej nga ana e Bashkimit Evropian. “Është jetike që BE-ja të mbështesë rajonin dhe të miratojë liberalizimin e vizave për Kosovën. Jemi të zhgënjyer nga vendimi për të mos nisur negociatat, sepse këto shtyrje kanë penguar përparimin e synimeve tona në rajon, jo vetëm

normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë por, më shumë se kaq”, ka deklaruar Palmer, duke theksuar se “për ta realizuar potencialin e plotë të këtij rajoni, liderët duhet të bëjnë më tepër se premtime, “duhet të marrin masa dhe të zgjidhin çështjet politike brenda dhe jashtë vendit, të fuqizojnë demokracitë shumetnike dhe sistemet e drejtësisë dhe të lëvizin drejt së ardhmes”, ka thënë Palmer.

Palmer ka theksuar se “udhëheqësit në rajon duhet të marrin një qëndrim të vendosur për të ardhmen e tyre evropiane” dhe se “Shtetet e Bashkuara besojnë se përpjekjet e rajonit për të krijuar një treg të përbashkët rajonal janë hapa normalë në rrugën drejt anëtarësimit në BE”.

Palmer ka theksuar edhe nevojën për reforma në ekonomi dhe luftimin e korrupsionit e krimin të organizuar. “Përveç

ekonomisë, qytetarët në rajon janë më të shqetësuar për korrupsionin. Lufta kundër korrupsionit paraqet bazë për ruajtjen dhe forcimin e demokracisë”, ka deklaruar Palmer.

Ministri i Punëve të Jashtme i Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, na fjalimin e tij ka thënë se integrimi evropian mbetet qëllimi kryesor i vendeve të rajonit, ndërsa edhe një herë e vlerësoi të mirë propozimin e presidencës së deritanishme të BE-së, Portugalisë, për zgjidhjen e kontestit me Bullgarinë, që pamundësoi hapjen e negociatave me BE-në. Ai ka thënë se në konferencën dyditore ndërkombëtare “Prespa Forum” u hapën tema të rëndësishme, të cilat, njëkohësisht, janë sfida të Forumit, siç janë dialogu, mirëbesimi dhe çështja e integritetit të vendeve nga Ballkani Perëndimor.

Dhjetë raste të reja me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 1 KORRIK - Në Kosovë u regjistruan të enjten edhe dhjetë raste me Covid-19. Sipas një njoftimi të Ministrisë së Shëndetësisë, rastet e reja pozitive rezultuan pas testimit të 1 580 mostrave. Në 24-orëshin paraparak nuk u regjistrua asnjë viktimitë nga koronavirusi, ndërsa u shëruan 12 pacientë. Kosova ka regjistruar gjithsej 107 768 raste, 2 258 viktima dhe 105 345 të shëruar.

Aktualisht raste aktive janë 165. Fushata e vaksinimit në Kosovë ka nisur në fund të marsit. Deri të enjten, sipas Ministrisë së Shëndetësisë, janë vaksinuar 189 006 persona. Prej këtyre, 45 015 vetë i kanë marrë nga dy doza. Kroacia ndau të enjten 20 000 vakcina kundër koronavirusit për Kosovën.

Kryeministri i këtij vendi, Andrej Pllenkoviç, ka thënë se sasi e njëjtë dozash do të ndahet edhe për Malin e Zi, Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut dhe Kirgizinë, ndërsa për Bosnje e Hercegovinën do të ndahen 210 000. “Në bazë të porosive tona, do të kemi doza të mjaftueshme dhe do të bëjmë edhe donacione të tjera gjatë vitit”, ka thënë Pllenkoviç. Tash për tash nuk është e



qartë se të cilit prodhues janë vaksinat e dhuruara. Kroacia i ka dhuruar më herët

Kosovës edhe 10 000 vakcina të cilat janë dorëzuar në muajin qershor.

ShBA-ja pret që Kosova dhe Serbia t'i përmbahen marrëveshjes së Uashingtonit



PRISHTINË, 1 KORRIK - Shtetet e Bashkuara presin që Kosova dhe Serbia t'u përmbahen detyrimeve të marra në Uashington më 4 shtator 2020. "Shpresojmë që partnerët tanë të veprojnë me mirëbesim dhe të vazhdojnë t'u përmbahen detyrimeve të marra përsipër në Uashington", thuhet në një përgjigje të Departamentit Amerikan të Shtetit për "Zërin e Amerikës" në gjuhën serbe. Kosova dhe Serbia, më 4 shtator 2020, kanë nënshkruar në Shtëpinë e Bardhë në Uashington, dy dokumente për normalizimin e raporteve ekonomike, në prani të ish-presidentit amerikan Donald Trump. Marrëveshja ishte nënshkruar mes ish-kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq. "Zbatimi i marrëveshjes së Uashingtonit krijon një bazë për marrëveshjet e ardhshme dhe ofron mundësi për bashkëpunim më të gjerë midis palëve. Detyrimet e marra veçse sjellin përfitime për qytetarët e

Serbisë dhe Kosovës dhe ne i inkurajojmë ta vazhdojnë zbatimin e tyre", thuhet në përgjigjen e Departamentit të Shtetit. Marrëveshja, ndër të tjera, parasheh angazhimin e Kosovës dhe të Serbisë në ndërtimin e lidhjeve rrugore dhe hekurudhore, për t'i lidhur kryeqytetet e tyre në mënyrë që ta përmirësojnë lëvizjen e mallrave dhe njerëzve, zhvillime këto që mund të tërheqin investime perëndimore. Sipas marrëveshjes, Kosova obligohet të bëhet pjesë e një iniciative për lëvizjen pa pasaporta dhe detyrime tarifore, që do ta përfshijë Shqipërinë, Serbinë dhe Maqedoninë e Veriut. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i pyetur të mërkurën pas mbledhjes së qeverisë për zbatimin e saj, ka minimizuar pikat e tjera të Marrëveshjes së Uashingtonit, duke thënë se "pika më e rëndësishme e saj është ajo e fundit, e cila tashmë është realizuar". Fjala është për njohjen e ndërsjellë në mes të Kosovës dhe

Izraelit. Shtetet e Bashkuara u kanë dorëzuar javën e kaluar, Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Serbisë, studimin e fizibilitetit për Liqenin e Ujmanit. Ky studim shënon përbushjen e një prej angazhimeve të Marrëveshjes së Uashingtonit. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se është detyrë e institucioneve që Liqenin e Ujmanit ta konsiderojnë si "liqe artificial të Kosovës". "Qëndrimet tona në lidhje me Ujmanin janë të njëjta", ka deklaruar Kurti në një konferencë për media të mërkurës pas mbledhjes së Qeverisë së Kosovës. Raporti propozon formimin e një komisioni apo komiteti për lumin Ibër, që do ta ndihmonte diskutimin midis palëve për mundësitë e menaxhimit të burimeve ujore. Ujmani është një liqen artificial, i ndërtuar në shtratin e lumit Ibër, në veri të Kosovës. Kryeministri Kurti ka thënë se mund të prodhohen analiza e studime, por është "detyrë e jona

që ta konsiderojmë Liqenin e Ujmanit, ashtu siç është, liqe artificial i Kosovës". "Atë (Liqenin) e kemi paguar dhe kryer shumë dekada më parë", ka thënë Kurti. Liqeni u ndërtua në vitin 1972, me një kredi prej 45 milionë dollarësh amerikanë, që ishte marrë nga Banka Botërore, marrëveshje kjo e ratifikuar atëherë nga Kuvendi Krahinor i Kosovës dhe Kuvendi Federativ i Jugosllavisë. Serbia insiston se ka trashëguar borxhin e ish-Jugosllavisë, prandaj pretendon se ka të drejtë në pronësi. Ish-kryeministri Avdullah Hoti lidhur me këtë çështje, javën e kaluar, ka shkruar në rrjetin social "Facebook", duke thënë se qeveria duhet të kujdeset për realizimin e projekteve që burojnë nga Marrëveshja e Uashingtonit. "Administrata e presidentit Biden e ka konfirmuar se do të vazhdojë të realizojë këtë marrëveshje, sepse është në përputhje me interesat e përbashkëta të ShBA-së dhe të

Kosovës", ka shkruar Hoti. Jehona Lushaku-Sadriu, profesore në Departamentin e Shkencës Politike në Universitetin e Prishtinës, në një bisedë me "Radion Evropa e Lirë" ka vlerësuar se në raport me dialogun me Serbinë, qasja e paqartë e Qeverisë së Kosovës është peng i deklaratave të mëhershme të kryeministrit Kurti. Sipas saj, Kurti më herët ka shprehur qëndrime mjaft kritike lidhur me dialogun me Serbinë për marrëveshjet e arritura në këtë proces, por edhe për zotimet e 4 shtatorit në Uashington. "Marrëveshjet, të cilat janë nënshkruar dhe kanë hyrë në fuqi, janë punë e përfunduar ashtu sikurse edhe Marrëveshja e Uashingtonit. Ne duhet të mendojmë se jemi shtet që merr obligime ndërkombëtare dhe pavarësisht se kush është kryeministër, shteti duhet të vazhdojë t'i zbatojë marrëveshjet të cilat i ka nënshkruar vetë dhe është zotuar se do t'i zbatojë", ka thënë Lushaku-Sadriu.

Më 7 korrik Kuvendi diskuton për marrëveshjen e Uashingtonit

PRISHTINË, 1 KORRIK (ER) - Kryesia e Kuvendit të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur të enjten të drejtuar nga Glauk Konjufca, kryetar, vendosi që të mërkurën, më 7 korrik 2021, në orën 10:00, të mbahet seancë e rregullt. Seanca e së mërkurës do të fillojë me deklaratimet jashtë rendit të ditës, për të vijuar me pyetjet parlamentare. Pas këtyre pikave, kryesia vendosi që pikë e radhës së rendit të ditës të jetë propozim-rezoluta për gjenocidin në Srebrenicë. Seanca e rregullt do të vijojë me debat parlamentar në lidhje me veprimet e Qeverisë së Kosovës

për zbatimin e marrëveshjes së Uashingtonit sipas propozimit të grupit parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Pas debatit parlamentar, seanca do t'i vijojë punimet për shqyrtimin e Raportit Vjetor të Performancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2020; shqyrtimin e Raportit Vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2020, dhe shqyrtimin e Raportit të Punës së Akademisë së Drejtësisë për vitin 2020. Në rend dite, kryesia vendosi edhe shqyrtimin e rekomandimit të Komisionit

funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës. Po ashtu, kryesia vendosi që të fusë në rend dite për këtë seancë edhe zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit për Trashëgimi Kulturor, si dhe zgjedhjen e një anëtar të Autoritetit Rregullativ të Ujit. Kryesia në këtë mbledhje ka vendosur që të formojë një grup punues për përgatitjet në lidhje me shënimin e 20-vjetorit të themelimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës.



“Bashkë dhe krenarë”, komuniteti LGBTI mban paradë në Prishtinë

PRISHTINË, 1 KORRIK (ER) - Në Kosovë është mbajtur të enjten parada e pestë e krenarisë e komunitetit LGBTI. Qindra pjesëmarrës kanë marshuar në sheshin kryesor të kryeqytetit,

Prishtinë, duke valëvitur flamuj me ngjyra ylberi dhe duke vallëzuar. Pjesëmarrësit thanë se parada për ta përfaqëson liri, barazi dhe festë, por edhe protestë për të drejta të barabarta.



Fillon fushata e korrje-shirjeve në Rahovec

RAHOVEC, 1 KORRIK (ER) - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Laitifi, ka bërë me dije se në këtë komunë të enjten zyrtarisht ka filluar fushata e korrje-shirjeve. “Dihet

se gruri është një kulturë strategjike për vendin tonë, ndaj fermerët tanë i përgëzoj për punën dhe përkushtimin e tyre, me shpresën të kemi një vit sa më të mbarë. Gjithashtu,

uroj të kemi rendimente më të larta të prodhimit në mënyrë që sadopak t’u shpërblehet djersa dhe mundi i punës së tyre. Qoftë vit i bereqetshëm!”, ka thënë kryetari Latifi.

Ndahen çmimet për shkollat fituese në projektin “Së bashku kundër abuzimit të fëmijës”

KAMENICË, 1 KORRIK (ER) - Komuna e Kamenicës së bashku me “Qendrën për Arsim të Kosovës-KEC” kanë ndarë çmimet për shkollat fituese në projektin “Së bashku kundër abuzimit të fëmijës”, projekt ky i cili kishte për qëllim që të gjithë fëmijët të trajtohen me respekt të plotë dhe dinjitet, duke promovuar kështu mjedis pa abuzime në ambientet shkollore.

I pari i komunës, Qëndron Kastrati, është shprehur i lumtur që shkollat e kësaj komune janë duke ofruar shërbime të volitshme dhe ambiente të sigurta për mbarëvajtjen e mësimin. “Krijimi i një ambienti të sigurt, trajtimi i nxënësve me dinjitet

dhe respekt, është një nga çështjet e rëndësishme për ne. Prandaj, jam shumë i lumtur që shkollat e komunës sonë po ofrojnë shërbime të volitshme dhe ambiente të sigurta për mbarëvajtjen e procesit mësimor”, ka thënë ai.

Ndërsa zyrtarja pranë Drejtorisë Komunale të Arsimit, Lejla Leci, u shpreh mirënjohëse ndaj të gjithë atyre që nuk u kursyen në asnjë moment duke dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në të gjitha fushat. Edhe menaxherja e projektit, Ardita Kabashi, është shprehur mirënjohëse ndaj të gjithë atyre që vazhdimisht po punojnë për mirëqenien e nxënësve, pa dallim etnie dhe përkatësie.



Komuna e Malishevës ndihmoi 150 bujq me motokultivatorë



MALISHEVË, 1 KORRIK (ER) - Komuna e Malishevës përmes Drejtorisë për Bujqësi, në kuadër të përkrahjes përmes subvencioneve, të enjten i ka përkrahur 150 bujq me motokultivatorë. Kjo përkrahje është pjesë e subvencioneve nga thirrja për përkrahje me mekanizëm bujqësor të datës 19.04.2021, thirrje nga e cila do të përfitojnë edhe shumë bujq të tjerë, në mekanizëm tjetër në bujqësi.

Në fillimin e shpërndarjes së motokultivatorëve për 150 bujq malishevas, ishin të pranishëm nënkryetari i komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, drejtori komunal për Bujqësi, Murat Hoxha dhe zyrtarë të tjerë të drejtorisë përkatëse. “Kjo është

vetëm një pjesë e përkrahjes së komunës për bujqit në kuadër të thirrjes për përkrahje me mekanizëm bujqësor, por përkrahja do të vazhdojë edhe me subvencione të tjera, pasi bujqësia është dega më e qëndrueshme dhe arteria kryesore e zhvillimit ekonomik në komunën tonë”, ka thënë Berisha.

Drejtori komunal për Bujqësi, Murat Hoxha, ka bërë me dije se në kuadër të kësaj thirrje për përkrahje, bujqit e komunës sonë, përveç 150 motokultivatorëve, do të përfitojnë edhe shpërndarëse plehu kimik, makina për spërkatje dhe makina mjelëse për lopë, por përkrahja do të vazhdojë edhe në fushat e tjera të bujqësisë.

GLPS-ja: Në këtë 100-ditësh më shumë ka pasur premtime sesa rezultate të prekshme

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 1 KORRIK- Përfaqësues të Grupit për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) kanë mbajtur të enjten konferencë për media me temën "Vlerësimi i 100 ditëve të para të qeverisë Kurti II". GLPS-ja ka bërë një vlerësim të përgjithshëm të punës së qeverisë Kurti II për 100 ditët e para. Fillimisht në këtë konferencë janë shpalosur vlerësimet që GLPS-ja i ka dhënë qeverisë në pesë kategori, më pastaj është bërë një vlerësim më i hollësishëm për sektorët më të rëndësishëm të qeverisjes. Në fushën e rimëkëmbjes ekonomike, GLPS-ja ka theksuar që qeveria Kurti deri më tani nuk ka arritur që shumicën e objektivave dhe masave ekonomike t'i përfundojë në këtë tremujor të parë. GLPS-ja ka vlerësuar se e shihet me shqetësim që deri më tani vetëm 6 milionë euro janë ndarë për mbështetjen e sektorit privat të prekur nga

pandemia, gjegjësisht sektorin e gastronomisë dhe transportit privat. "Aspekt pozitiv vlerësohet kalimi në lexim të parë i heqjes së homologimit, si politikë progresiste në shërbim të qytetarit. Gjithashtu, një serë bordesh të ndërmarrjeve publike janë shkarkuar dhe zëvendësuar me borde të reja, veçse ende nuk është paraqitur ndonjë strategji nga qeveria dhe bordet e reja për rivitalizimin e këtyre ndërmarrjeve", thuhet në vlerësimin e GLPS-së.

GLPS-ja vlerëson se në këtë 100-ditësh më shumë ka pasur premtime dhe objektiva të paraqitura sesa rezultate të prekshme në të gjithë sektorët e zhvillimit ekonomik dhe rimëkëmbjes nga pandemia në veçanti.

Te fusha e sundimit të ligjit, GLPS-ja ka konkluduar se qeveria ka ndërmarrë disa iniciativa për të iniciuar reforma në këtë fushë, respektivisht në vetting, në konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme dhe në krijimin e Gjykatës



Komerciale.

Sa i përket agjendës legislative, është thënë se agjenda legislative që qeveria Kurti II ka publikuar është tejet ambicioze dhe afatet kohore nuk janë realiste. "Kur krahasohet me agjendat legislative të pesë vjetëve të fundit, qeveria Kurti II ka numrin më të lartë të iniciativave të reja për të ndryshuar dhe plotësuar ligjet

ekzistuese. Nga 93 projektligje të reja, 29 janë nisma të reja legislative, ndërsa 64 janë trashëguar nga agjendat e mëparshme. Sa i përket performancës në këtë fushë, qeveria Kurti II mbetet e ngadaltë në ritmin e saj për ta përmbytur agjendën legislative të vitit 2021. Bazuar në analizën e GLPS-së, vetëm 14.5 për qind e agjendës legislative është përmbytur

ose iniciuar, dhe do të jetë e vështirë të zbatohet tërësisht deri në fund të vitit", theksohet në vlerësimin e GLPS-së.

Në politikën e jashtme është thënë se nuk ka strategji të qartë për reformim të shërbimit të jashtëm. Ndërsa te dialogu, GLPS-ja ka thënë se qasja e Kurtit në takimin e parë në dialog paraqiti një ndryshim në krahasim me paraardhësit e tij. "Përveç kërkesës për njohje nga Serbia, kryeministri Kurti bëri katër propozime që përfshinin çështjet nga bashkëpunimi rajonal ekonomik, marrëveshja e paqes, e deri te për personat e zhdukur. Sidoqoftë, nuk u arrit asnjë konsensus për propozimet e Kurtit dhe as për agjendën e dialogut. GLPS e shihet si deficit mosarritjen e konsensusit të brendshëm politik mbi vijueshmërinë e dialogut Kosovë - Serbi dhe mungesën e një platforme të qartë dialoguese ku parashihen objektiva të qarta nga ana e Kosovës", thuhet në vlerësimin e GLPS-së për 100 ditët e para të qeverisë Kurti II.

Fillojnë patrullimet e përbashkëta në mes të Policisë së Kosovës dhe Policisë së Shqipërisë



PRISHTINË, 1 KORRIK (ER)- Pas nënshkrimit të memorandumit të bashkëpunimit në mes të dy drejtorëve të dy policive, Policisë së Kosovës dhe Policisë

së Shqipërisë, për patrullime të përbashkëta në disa akse rrugore, të enjten ka filluar së zbatuari ky memorandum. Grupi i parë i zyrtarëve policorë

të trafikut nga Policia e Kosovës ka filluar patrullimet në territorin e Republikës së Shqipërisë, pastaj do të vazhdohet me grupet e tjera.

"Për të gjithë drejtuesit e automjeteve (jo vetëm për ata që shkojnë në Shqipëri), të respektohen rregullat dhe shenjat e trafikut, të kihet

kujdes maksimal në sigurinë në trafik. Respektimi i rregullave dhe kujdesi në trafik shpëton jetë", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Shqiptohen mbi 1 000 gjoba për shoferët që përdorin telefonin gjatë ngasjes

PRISHTINË, 1 KORRIK (ER)- Policia e Rajonit të Prishtinës, respektivisht njësi rajonal i trafikut rrugor, duke u mbështetur në vlerësimet e fundit që i ka bërë situatës së sigurisë në trafik, që nga data

21 qershor 2021 ka filluar zbatimin e një plani operativ për kontrollin e shtuar në trafik, me fokus të veçantë ndaj ngasësve të cilët përdorin telefonin gjatë vozitjes.

Në kuadër të këtij plani deri më sot janë shqiptuar 1 198 gjoba për këtë lloj kundërvajtje. "Janë shqiptuar 129 tiketa, masa administrative për kundërvajtje të ndryshme në

trafikun rrugor. Ky operacion do të ketë shtrirje në të gjitha rrugët e rajonit të Prishtinës dhe do të vazhdojë derisa të vlerësohet që është arritur efekti i dëshiruar", ka njoftuar Policia e Kosovës.



Diaspora nuk do ta paguajë sigurimin kufitar për vetura

Vendimi për njohje reciproke të policave TPL plus me Malin e Zi si dhe vendimi për kompensimin e policave për automjetet dhe motoçikletat e bashkatdhetarëve kanë hyrë në fuqi më 1 korrik

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 1 KORRIK- Qytetarët e Kosovës që jetojnë dhe punojnë në shtete të ndryshme të Evropës nga dita e enjte (1 korrik) nuk do t'i paguajnë sigurimet kufitare kur hyjnë në Kosovë.

Ministri i Financave dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka thënë se me marrëveshjen e arritur me Bankën Qendrore dhe Byronë Kosovare të Sigurimeve, qeveria mbulon çmimin e reduktuar për 35 për qind. "Prej sot mërgata nuk ka nevojë të paguajë për policën kufitare. Me marrëveshjen e arritur me Bankën Qendrore dhe Byronë Kosovare të Sigurimeve, qeveria mbulon çmimin e reduktuar për 35 për qind. Nëse llogariten edhe kursimet e tarifave bankare, me këtë marrëveshje do të kursehen mbi 3 milionë euro", ka shkruar Murati në rrjetin

social "Facebook".

Personat që hyjnë në Kosovë me autovetura është dashur të paguajnë 15 euro për qëndrimin prej 15-ditësh. Ndërkaq, qëndrimi për një muaj kap vlerën e sigurimit prej 20 eurosh. Këto tarifa ndryshojnë nga kategoria e mjeteve motorike dhe periudha e qëndrimit në Kosovë.

Edhe drejtori i Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), Sami Mazreku, ka folur për vendimin për njohjen reciproke të policave TPL plus me Malin e Zi si dhe vendimin për kompensimin e policave për automjetet dhe motoçikletat e bashkatdhetarëve.

Mazreku ka thënë se të dyja vendimet janë shumë të rëndësishme si për lehtësim të qarkullimit, por do të kenë impakt edhe në aspekt financiar pasi që, sipas tij, qytetarët e Kosovës për të



kaluar në Mal të Zi mund ta shfrytëzojnë vetëm policën TPL plus e cila vlen edhe për Maqedoni dhe Serbi, derisa për bashkatdhetarët të cilët hyjnë nga 1 korriku në vendin tonë, Qeveria e Kosovës do ta mbulojë policën.

Mbështetja për mërgatën me vlerë prej pesë milionë eurosh është paraqitur edhe në Pakon e Ringjalljes Ekonomike, të publikuar të mërkurën nga Qeveria e Kosovës.

Në pako thuhet se do të mbulohet kostoja e reduktuar

e policës kufitare për të gjithë mërgimtarët që vijnë në Kosovë derisa të zgjidhet përfundimisht çështja e anëtarësimit të Kosovës në Kartonin e Gjellbër.

Kartoni i Gjellbër vërteton se një automjet përfiton në mënyrë të mjaftueshme nga mbulimi i përgjegjësisë nga siguri. Kështu, kur makina përfshihet në një aksident në territorin e një shteti ku vlen sistemi i Kartonit të Gjellbër, siguri mbulon koston (e lëndimit, dëmtimit etj.).

Përprjekjet e autoriteteve në Kosovë për anëtarësim në Këshillin e Byrove Evropiane, që siguron Kartonin e Gjellbër, po sfidohen nga dy probleme thelbësore. Së pari, Kosova nuk është shtet anëtar i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe, së dyti, në Kosovë ka një numër të madh të automjeteve të paregjistruara të cilat janë edhe të pasiguruara në qarkullim, çka e bën të pamundur sigurimin e Kartonit të Gjellbër.

OAK-u kundër moratoriumit të propozuar nga ministri Aliu për gurthyesit

PRISHTINË, 1 KORRIK (ER)-Oda e Afarizmit e Kosovës (OAK) ka ngritur shqetësimin e saj ndaj paralajmërimeve se ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, do të marrë vendim mbi moratoriumin për gurthyesit e ri dhe ata në procedurë për pëlqim mjedisor në periudhën qershor 2021 - qershor 2023. Sipas OAK-ut, vendimi i propozuar për mosvazhdimin e licencave që skadojnë në qershor të këtij viti dhe



mospajisjes së gurthyesve të ri me leje përkatëse për ta vazhduar operimin e këtij sektori, është jashtëzakonisht shqetësues për sektorin

minerar, duke marrë për bazë dëmet materiale pas investimeve të shumta në pajisje dhe makineri të cilat u shkaktohen këtyre të fundit

dhe humbjet e qindra vendeve të punës që janë të angazhuar në këtë sektor. "Bizneset anëtare të OAK-së nga sektori minerar shprehen jashtëzakonisht të shqetësuara lidhur me vendimin i cili pritet të merret, ndërsa theksojnë se pezullimi i punës për një periudhë kohore për dy vjet, edhe ashtu pas ballafaqimit me gjendjen pandemike në vend, do të jetë shumë i dëmshëm në të gjitha format. Oda e Afarizmit e Kosovës kërkon nga Ministria e

Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës që paraprakisht të konsultohet me bizneset duke pasur parasysh se është pikërisht ky sektor i cili preket drejtpërsëdrejti nga një vendim i tillë", është thënë në reagimin e OAK-ut. Për më tepër, OAK-u ka sqaruar se nuk është kundër dhënies së licencave të reja, por ka kërkuar që një vendim i tillë të unifikohet me KPMM-në në mënyrë që së pari ata ta ndalojnë dhënien e licencave.

Shmangia e detyrimeve tatimore, ATK-ja me aktivitete intensive

PRISHTINË, 1 KORRIK (ER)-Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), në bazë të planit të punës dhe planit për trajtimin e rreziqeve, ka hartuar planin operativ të veprimit i cili ka në fokus inspektimin e aktiviteteve ekonomike që zhvillohen nga ana e tatimpaguesve. Plani i veprimit korrik - shtator 2021 në fokus të aktiviteteve do të ketë bizneset të cilat përmes shumë indikatorëve të riskut dalin në pah deklarimet e tyre jo të sakta andaj, sipas

ATK-së, do të bëhet verifikimi dhe korrigjimi i deklarimeve të tyre kundrejt qarkullimit/fitimit të realizuar.

Në mënyrë që ky plan të përfshijë të gjitha grupet e synuara, inspektorët tatimorë do të zhvillojnë aktivitete brenda dhe jashtë orarit zyrtar të punës, edhe në fundjavë. Aktivitetet e ATK-së me këtë plan do të orientohen në veprimet specifike, si identifikimi i bizneseve dhe personave fizikë të cilët përmes

dokumentacionit jo të saktë iu shmangen detyrimeve tatimore. "Po ashtu, do të bëhet identifikimi dhe fiskalizimi i bizneseve të cilat nuk janë pajisur me arka fiskale si dhe ndërmarrjen e masave ndaj bizneseve të cilat janë pajisur me arka fiskale, por nuk lëshojnë kuponë fiskalë, identifikimi dhe trajtimi i bizneseve dhe personave fizikë të cilët bëjnë nëndeklarim të shitjeve (të ardhurave) si dhe nëndeklarim të numrit të



punonjësve dhe pagave, si dhe identifikimi i mosdeklaruesve, ndalim deklaruesve si dhe ndërmarrjen e veprimeve të

tjera ligjore me qëllim që tatimpaguesit të bëjnë deklarimet e tyre saktë dhe brenda afateve kohore", ka njoftuar ATK-ja.

Provokimi në shërbim të mitit serb



Nga: Aurel PLASARI

La zananë e zu zuranë: kështu do t'i thuhej, me një fjalë të vjetër shqipe, ndërrimit të profesionit nga z. Richard Grenell, i cili është vënë të provokojë historinë e popujve të Evropës juglindore, kinse për të përkujtuar Betejën e Kosovës të vitit 1389, duke e lidhur me festën fetare të Kishës serbe – kujtimin e martirizimit të Shën Vitos, – madje edhe me do “Serbian holy martyrs” të betejës në fjalë.

Beteja e Kosovës e vitit 1389 ishte betejë e një koalicioni të vogël “të krishterë” ballkanas – serbë, arbërorë, boshnjakë – kundër ekspandimit turko-osman në rajon. Despoti Lazar Grebljaniviq, bir dobiç i Stefanit Dushanit, kishte qenë deri aty më parë vasal i sulltanit dhe haraçpagues i tij nëpërmjet një traktati të 1375-s, por u vu në krye të ushtrisë së koalicionit sepse gëzonte titullin me të lartë në titullaturën e koalicionit. Në Mesjetë hierarki të tilla, sidomos në fushata luftarake, funksiononin. Nën komandën e tij i quajtur “koalicion i të krishterëve ballkanas” u thye prej ushtrisë turke.

Falë burimeve osmane, përplot me hollësi për këtë betejë, mund të rindërtohen me përafërsi edhe formacionet, përfshirë edhe pjesëmarrjen e arbërorëve [Arnavud] ose të “trupave arbërore” [Arnavud Askeri] në koalicionin në fjalë. Në formacionin luftarak nga ana

e të krishterëve: në mes despoti Lazar me të birin; në të djathtë nipi dhe dhëndri i tij Vuk Brankoviq dhe Gjergji II Balsha, bir i Strazimir, që ishte po ashtu dhëndër i Lazarit ngase i kishte marrë për grua të bijën Jelena (“një i pafe me emrin Jorgji” në burimet osmane ose “sundimtari i Shkodrës së Arbërisë” [Arnabud Iskenderijesi hakimi] etj.); në të majtë prijësi i Bosnjës Tvrtko dhe fisniku arbëror Dhimitër Jonima (“Jund-oglu” në burimet osmane), si edhe ndonjë tjetër prijës arbëror që kronistët osmanë e kanë quajtur “sundimtari arnaud”, ose edhe vetë Theodor Muzaka, sikurse vetë kronisti i Muzakëve e mëton. Të gjithë këta prijës kishin të rreshtuar mbas vetes trupat përkatëse: serbe, arbërore, boshnjake.

Nga ana e turqve: trupat pararojë komandohehin nga Gazi Evrenos-beu dhe Jigjit-beu; në mes ndodhej vetë Murati I, komandant i epërm; në të djathtë i biri Bajazit, Saruxha-pasha dhe Gazi Evrenos-beu, Ali-pasha etj.; në të majtë biri i tij i dytë Jakup, bejlerbeu i Rumelisë Kara Timurtash-pasha, Toxha Ballaban-beu dhe Ine-be Subashi etj.

Çfarë nuk thuhet rëndom – sa për t'ia gudulisur pakëz profesionin e riz. Grenell – është që në ushtrinë e sulltanit bënin pjesë edhe dinastë serbë, si knjazi Kostandin i Velbuzhdit dhe “heroi

legjendar” i sllavëve të Jugut, Marko Kraljeviq, të cilin baladat popullore serbe e himnizojnë për luftërat e tij “kundër turqve”. I lëmë kohë z. Grenell që, jo në datën e fillimit të betejës, siç ka bërë, por në datën e përfundimit të saj, t'i përkujtojë edhe këta si “Serbian holy martyrs”.

Me fitoren e turqve, si edhe me vrasjet e sulltanit Murat I dhe atë të despotit Lazar, Bajaziti I, që u shpall sulltan në fushën e betejës mbas vrasjes së t'et, si politikan dinak u shtir sikur nuk desh të përfitonte “deri në fund” nga kjo mundje. Dy bijtë e despotit të vranë, Stefanin Lazareviq dhe Vukun Lazareviq, i thirri dhe me më të madhin, Stefanin, lidhi një traktat. Nëpërmjet tij e linte atë zot në ish-zotërimet e t'et me kushtet që t'i paguante haraçin përvjet dhe të vente me ushtri në shërbim të sulltanit sa herë që ky t'ia kërkonte. Me të njëjtin traktat Stefani i jepte sulltanit motrën e vet Olivera për “martesë kanonike” (nigâh).

Për të mos ia lënë të gjithë pushtetin Stefanit Lazareviqit, Bajaziti ia linte dhëndrit të Lazarit, Vukut Brankoviq, një krahinë të tërë – pak a shumë të përputhshme me Kosovën e sotme – me qendër Prishtinën. Më 1391 Bajaziti i do të dërgonte aty Jigjit-beun. Ky, si hidhte dorë mbi minierat e Kratovës dhe pushtonte Shkupin (Ūsküb), hiqte m'anësh Vukun dhe vendosej aty guvernator. Në viset

në fjalë Bajaziti I fillonte një proces të mirëfilltë kolonizimi.

Motrën sulltanit do t'ia shpinin vetë dhuratë dy vëllezërit serbë, Stefani dhe Vuku, mbas një viti të Traktatit. Ata mandej do të kalonin në oborrit e Bajazitit disa kohë për çdo mot duke e shoqëruar atë jo vetëm në fushatat e tij me trupat e tyre, por edhe në parti të gjahut, shkurt: duke u dëftuar vasalë të bindur të atij që u punonte motrën.

Për ç'u takon arbërorëve, mundja e koalicionit të “të krishterëve ballkanas” në Betejën e Kosovës nuk mund të ishte pa ndikime, qoftë edhe të tërthorta, mbi ta. Por, qëndresa e tyre do të vijonte. Ishte ai që tradita historiografike e quan “Moti i madh” ose Shekulli i Skënderbeut, qëndresë që llogaritet nga inkursionet e para të turqve osmanë në tokat shqiptare, 1380, deri me rënien e Shkodrës, 1479, mbas vdekjes së Gjergj Kastriotit.

Përfundimi se “kjo fitore e stabilizoi fuqishëm sundimin e turqve në Ballkan”, i përsëritur nga Inalciku e kënde, rezultoi i tepruar. Tepria në vlerësimin e kësaj beteje duket ta ketë zënë fillin te historishkrues njëanshmërisht proserbë, si një William Miller, i cili e quante atë “beteja që do të vendoste për pesë shekuj fatin e Gadishullit të Ballkanit...”. Afërmendsh që për zmadhimin e kësaj beteje kanë ndikuar vetë kronistët osmanë, duke filluar nga bejtet e

Ahmediut të shek. XV. “Kujat çapiteshin mbi kufomat që ishin kat-e-kat njëra mbi tjetrën”, e përshkruajnë fushëbetejën edhe ‘Kronikat Anonime’ në kapërcyell të shekujve XV-XVI. Kronistët e oborrit të sulltanëve mezi prisnin rastet e fitoreve të zotërve të tyre për të vepruar kështu.

Për balkanologun dhe albanologun emërmadh Nikolla Jorga, “1389-a nuk pati qenë veçse një incident i stërzmadhuar prej legjendës”. “Kryqëzata serbe nuk ka ekzistuar”, na siguron ai. “Ka historianë që mendojnë ende për një koalicion të madh të krishterë”, ka sqaruar Jorga, “që nuk ishte i mundshëm veçse për katolikët nën ndikimin e predikimit të urdhëruar nga Selia e Shenjtë”.

Këtë bërthamë historike të ngjarjes, me kalimin e kohës, serbët e veshën duke e fryrë me legjendat e tyre, çfarë nuk e bënë në traditën e vet popullore as shqiptarët, as boshnjakët, popuj më realistë si ndaj fitoreve, edhe ndaj dështimeve si ai i 1389-s. Për më shumë, veshja me legjenda e betejës në fjalë nuk ishte aq produkt i krijimtarisë popullore sesa i politikës serbe me një funksion të mirëfilltë diplomatik, i cili tanimë dihet botërisht: për të falsifikuar historinë e tyre para botës. Ndërsa z. Grenell me “përkujtimin” e tij vetëm sa ka ngritur këmbën që t'i vënë gozhdën.



Elemente të realizmit magjik, në poezinë e Xhevdet Bajrajt

Takimi me poezinë e Bajrajt ishte shumë befasuese, por në realitetin shqiptar, këtej dhe andej Drinit, ne folim dhe shkruajmë vetëm *post-mortun*, duke i "njohur" aq shumë vlera deri në tepri, duke e ngritur në qiellin e *Epërm si Hyjni*, por kur është gjallë ose do të *anatemohet*, do të *mënjanohet* apo me *kast do të harrohet*, ose ... ose thjesht do të *vegjetojë* si një *gjallesë*, pa kurrfarë interesi si poet apo shkrimtar, nëse nuk është pjesë e ndonjë *kasti* apo *klani* politik në arerën shqishkruese mbarëshqiptare. Meqë poeti jeton aq larg atdheut të tij, në *tokën e Majave* (një poezi palimpsest të mitologjisë së majave dhe të një kulture pak të njohur nga lexuesi shqiptar [shën. im. e.k]), ka një poezi të ndërtuar në *formë rrëfimi* (në kohën e shkuar), një teknikë jo shumë e njohur për poezinë shqipe (njihet në teknikën shkrimore të prozës).

Poezia e Bajrajt është një *ars combianata*, me shumë elemente si: nga poezia (letërsia e burgologjisë), *mitologjia shqiptare*, *e majave*, *elemente biblike*, *surrealiste*, *moderniste*, *eksitencialiste*, *realizmi magjik*, *hermetizmi* etj. Stili unik i personalizuar si referencë ndaj *postmodernizmit* (Sarup: 1993), brenda thagmës së termit *differencae*, duke ndërtuar semantikën tekstore mbi disa *topose gjuhësore*, poeti ka gjithërrokur nëpërmjet

përmasës së *kohës* dhe *hapësirës*, si në *diakroni* dhe *sinkroni*, ashtu edhe në rrafshin e leximit në *horizontalisht* dhe *vertikalisht* në formë *ambivalence* *themelore* (Lewalski; 1992), brenda teknikës së ndërtimit të tekstit, përpunon substancën e "thellë" të kujtesë kolektive (atdhetare) dhe personale (të burgut) kontrastin dhe diferencën e kuptimit, brenda *përpunimit ligjërimit*, që këlthet për ikjen, për mallin, për *absurdin e etnisë* dhe *të kombit*, ku "vlon" dhe rritet Pema e Gjakut dhe Pema e Tamblit lliro-Dardan.

Xhevat Bajraj ka botuar në Prishtinë dy libra të tij, "*Kafe me nënën*" (Bajraj: 2020) dhe vëllimi tjetër me poezi, "*Me zemër në qesë najlon*" (Bajraj: 2021). Linja e poezisë së Bajrajt është linja ku nëpërmjet *ekfrazës* (Baldick: 2001) (përshkrimi i peizazhit është një nga format më të zakonshme të ekfrazës), nëpërmjet tablove të krijuara, sendërton të tashmen dhe të shkuarën, nëpërmjet *shenjuesit konvencional [nënës]* si mungesë jo vetëm ligjërimit, por edhe si një imazh që evokon *pa-fajësinë fëmijërore*, ku ngërthehet aktualiteti shqiptar, me *nostalgjinë*, *mallëngjimin* për *vendlindjen*, edhe si kontrast me të gjitha kontinentet dhe *kulturat e shumta* (Vickers: 1988). Në këtë

vëllim poezia më e mirë është: "*De Niron do ta vrasin në fund të filmit*" kurse libri: "*Me zemër në qesë najlon*" ka tjetër tematikë. Libri ndahet në këto pjesë:

• *pjesa e parë ("Vatër")*, kryesisht është një *poemë me tetë* (8) pjesë, me titull: "*Kosova dhe shqipëria*", *pj. I*, vargjet: *ishte kohë e rëndë / qielli dhe toka përgatiteshin / t'i ndërronin vendet mes tyre / Shqipëria mezi qëndronte mbi gjunjë / liria duke se do t'i mbetej në fytyrë / Një kohë të gjatë / as poetët / s'dinin ç'të bënin me të / (duhet të gjendet një fjalë tjetër / për ndryshimet radikale në politikë) / pas shitjes së Murit të Berlinit / copa-copa / turistëve / Kosova bëhej gati të dhunohej / të digjej / të therej*, f. 3. Që në titull libri tregon për *zemrën në qese najloni*, një zemër që mbahet me kujdes në një qese, *por metaforisht*, zemra në qese nuk jeton, ajo vdes nga përmallimi, nga largësia në mërgim. Pjesa e parë, "*Vatër*", na servit situatën e fundviteve '80-të të shekullit të kaluar, ku *historia* mbart të gjitha ato *ndërlikime të origjinës* që transmentohen nëpërmjet poezisë dhe "tradita" përcakton *vetëdijen* (Dickinson: 1951); struktura që na jep hollësi në formë *rrëfimi* dhe *veprimi*, që nuk e koncepton poezinë në bazë të tekstit, por zgjeron fabulën duke lidhur *mendimin* dhe *botën* poetike, si një rrëfim në vetën e tretë.

• *pjesa e dytë ("Qengjat që nuk*

do të rriten"), ka gjithsejtë *tridhjetedy* (32) poezi. Në këtë pjesë poezia është me *subjekt nga e shkuara*, tematika të kohës së dhunës së luftës në Rahovec (mërgimi padrejtësisht i poetit në Meksikë). Në poezinë: "*Biberioni i përgjakur*", vargjet: *kufoma e foshnjës / e mbante rreth qafës / biberonin e përgjakur / Qau e qau derisa / viti i lindjes në gurin e varrit u bë / i njëjtë me vitin e vdekjes*, f.26, informacioni që përcjell poezia postmoderniste ka dy kahe: nga e shkuara tek e ardhmja dhe *anasjelltas*, gjendet në të gjitha kategoritë dhe tematikat *stilitike*, si poetika të *diskurseve të ndryshme*, ku *surrealja konvecionon realitetin*, nga stimulimi i të vërtetës, imazhi që krijon autori, duke ndërtuar një tension emocionalo-artistik, se dallimi mes *kufomës fizike* dhe *absurdit të fëmijës së vdekur*, lidh *objektin* dhe *subjektin*, *individin* dhe *realitetin*, *autorin* dhe *lexuesin*, *historinë* dhe të *vërtetën*, që janë sa anonime, aq edhe *perceptime personale* (Rosenau: 1992) të botës reale. Mënyra e shkrimit të temave si: "*Varreza masive prej uji (apo dy palë këmbë dhe një dorë)*" duket se poeti kërkon të mposhtë *absurdin e luftës*, deri tek titulli tjetër por aq *surreal*, nëpërmjet vargjeve: *kur u kthye burri pas disa ditëve / nga malet / të shihte / a e kishte shtëpinë në këmbë / hyri brenda e ndezi një cigare / dhe po i numëronte / gjërat që ia*

kishin vjedhur / Papritmas / një plumb që po qëndronte si në pauzë / brenda murit / e vazhdoi rrugën dhe u ndal / mu në gjoksën e tij, nga poezia: "*Vrima në mur*", f. 36, *vdekja irreal* nga plumbi metaforik, bashkohet me *supër(r)realen* që bashkëjetojnë në poezinë e Bajrajt, se është e pamundur të specifikojmë atë që ndan *realitetin* nga *poezia*, duke gjetur mënyrat për të dalluar poezinë si një marrëdhënie e përcaktimit të *formave të veçanta të realitetit* (Glück: 1992).

• *pjesa e tretë ("Tri poezi nga burgu i Pozharevcit dhe një poezi nga burgu i Dobravës")*, me katër (4) poezi, preket tematika e poetëve të ish-të burgosurve (në Shqipëri nga regjimi komunist dhe Kosovë nga regjimi serbo-sllav) apo ndryshe quhet letërsia (poezia) e *burgologjisë* (Zhiti: 2010), pjesë e së cilës ka qenë edhe vetë poeti, nëpërmjet vargjeve: *përnatë / e vizatonte një zog / në murin e qelisë së tij të burgut / por në mëngjes / nuk e gjente zogun aty*, f.51 nga poezia: "*Burgu i Dobravës*". Metafora e *zogut* dhe simboli i *burgut*, krijojnë *metoniminë e mungesës së lirisë*, se zogu është "pushtues" i hapësirave të lira, por edhe vetë poeti është "pushtues" i shpirtit të lira, nëpërmjet fjalës së lirë.

• *pjesa e katërt ("Skeleti i vajzës me kukulla")*, përbëhet me rreth *pesëdhjetë* (53) poezi, ose cikli

më i gjatë. Në këtë cikël poezitë: *"Peshkimi i një qeseje najloni"*, *"Skeleti i vajzës me kukulla"*, *"Këpucët prej lëkure"*, *"Me zemër më qese najloni"*, *"A guxoj ta prek me gisht Sarandën"* etj., janë poezi të dhembjes së mërgimit, që qartësojnë "zërin" biografik të poetit, nëpërmjet vargjeve: *kur e zë gjumi / i kujtohen ditët / e dhunës / që ranë si gjethe / të pemës së jetës / që kurrë më / nuk u vesh me to* f. 66, poezia: *"Me zemër me qese najloni"* poezitë kanë topika dhe (nën)topika si:

a) topika dhe (nën)topika e përshkrimit dhe karakterit, b) topika dhe (nën)topika e të kuptueshmes dhe thelbësore, c) topika dhe (nën)topika e arsyes dhe ndikimit, d) topika dhe (nën)topika e përjetimit të dhimbjes, e) topika dhe (nën)topika e dëshmimeve okulare, f) topika dhe (nën)topika e autencitetit në poezi, që nënkuptohen nëpërmjet ekstremeve të përvojës së dhimbshme (Wainwright: 2004), ku rrethina poetike shënjohet me imazhe metaforike, metonimi dhe sinedoka ku hapësira poetike dhe kohore, nëpërmjet konceptit dhe "formës", duke e plazmuar poezinë me elokuencën e ndërlikuar të fjalës poetike. Vargjet poetike: *kjo dëshmon / se përse jemi ndalur / e flemë / e hamë / e pimë / e bëjmë seks / përpara dritës së kuqe të semaforit të historisë*, f. 79, nga poezia *"Drita e kuqe e semafortit të historisë"*, poezi kjo që nëpërmjet përsëritjeve të [zanores (e)] shoqëruar me foljet: [flej / ha / pi / bëj] folje kryesisht lëvizore, historia njerëzore lëviz si vetë semafori. Duke i dhënë intesitet zanor dhe gjuhësor poeti, kërkon të përfitojë nga perceptuesit: *dhënësit* dhe *marrësit* nëpërmjet shenjave gjuhësore (Turner: 1998), se dallimi tip / shenjë mbetet një dallim midis vetive të perceptueshme dhe jo të (pa)perceptueshme.

• pjesa e pestë: (*"Ata janë më shumë"*), me nëntëmbëdhjetë (19) poezi. Në këtë cikël, poezitë janë kryesisht poezi ku poeti nëpërmjet ironisë dhe sarkazmës, "fshikullon" korrupsionin aktiv dhe pasiv, [-pseudot / -istët], politikanët, patriotët, poetët, historianët, atdhetarët egoistët, narcizistët, lajkataristët, maskilistët, feministët, nihilistët, ateistët, blafsemistët (të gjitha fushave dhe sferave) të atdheut të tij, edhe pse i dhembin dy pjesët e (për)gjysmuara të atë(mëmë)dheut. Vargjet: *kam frikë se politikanët tanë / kurrë nuk do të mund të mposhten / se ata janë katër a pesë / e populli / eh / populli është i vetëm*, f / 115, nga poezia: *"Ata janë shumë"*, duke theksuar semantikën e përmbajtjes dhe minimizimet sintaksore, lidhjet poetike dhe ndjeshmëria e tij "nervoze"

shpalon ironinë e thellë: nëpërmjet ironisë së fjalës dhe të jetës (Apolloni: 2016) (se)ndërtimi i raportit të ironisë gjithërok fatin e atdheut. Alegoria brenda metaforës së kuptimit në të gjitha nivelet e ndryshme të njohjes, krijon raporte të dukshme dhe të tërthorta njëkohësisht me ironinë, duke organizuar një strukturë enigmatike si:

– struktura e kuptimit,
– struktura ekzistencialiste,
– struktura intertekstuale,
– struktura dekonstruktiviste.
• pjesa e gjashtë: (*"Kënga e kumrisë"*), nënjësia me njëzetekatër (24) poezi. Janë poezi që trajtojnë tema më individuale, më personale, tema që lidhin kujtimet nga atdheu me mollët e mbjellura në bahçe nga babai, me peshën e

– (tej)optika e vetmisë dhe përjashtimit,

– (tej)optika e harmonisë së natyrës, vjen me vargjet: *nëpër të njëjtën dritare / hyri një / dallëndyshe / më mori me sqep / si të isha një fije kashte / dhe më dërgoi në pranverën / nga e cila më kishin përzënë / qëmoti* f. 141,

– (tej)optika e realizmit magjik, vargjet: *ju zotëri edhe pak do t'i mbushni 700 vjet / Ju / ju nuk keni / ju thjesht nuk mund të keni ardhmëri*, f. 162.

– (tej)optika e mitologjisë biblike+mitit të majave: një gjel këndon në orën një pas mesnate / ca thonë se kur gjeli këndon pa kohë / do të prishet moti / Pas ca orëve zbardhi dita / dielli lindi në kohë të caktuar / pa u vonuar as një sekondë / njerëzit dolën nga errësira f. 163, gjeli është

teknikave postmoderne që herë-herë i nënshtrohet keqpërdorimit (Walker: 1996), shumë më përtej zërit poetik realist, ekzistencialist, surrealist, deri tek magjia e realizmit magjik, ku poeti ngërthen Unin Poetik, kapet, mbahet, lundron, anon, mbulon, dredhon anësive të përditësisë letrare poetike dhe personale, për të (ri)gjetur një identitet të ri poetik. Vargjet e poezisë *"Zonja e shtëpisë"*: *brenda një shtëpie të braktisur / mbyllur me çelës nga jashtë / ulur në kolltuk / me shikim kah televizori i fikur / rrinte / ashtu si i ka hije / zonjës së shtëpisë / një vajzë e vogël / kukull / Buzëqeshjen e kishte të fikur / se ka vite / që iu kishin sosur bateritë*, f.166, është kombinimi mes mistikes dhe vizuales, mes reales dhe magjikes. Një

BIBLIOGRAFIA:

1. Apolloni, Ag: (2016), Parabola postmoderne, OM, Prishtinë.
2. Bajraj, Xhevdet: (2020), Kafe me nënën, "Armagedoni", Prishtinë.
3. Bajraj, Xhevdet: (2021), Me zemër në qese najloni, "Armagedoni", Prishtinë.
4. Baldick, Chris: (2001), The ConciseOxford Dictionary of Literary Terms, Oxford University Press.
5. Brunel, Pierre: (1992), Mythocritique et parcuris, PUF, Paris.
6. Dickinson, Emily: (1951), The Complete Poems of Emily Dickinson, Boston, London: Little, Broën.
7. Glück, Louise: (1992) The Wild Iris, Hopeëell, NJ: Ecco Press.
8. Ferber, Michael ; (1999), A Dictionary of Literary Symbols, Cambridge University Press.
9. Hammond, Norman: (1988), Ancient Maya Civilization, New Brunswick: Rutgers UP.
10. Holton, Gerald: (1973), Thematic Origins of Scientific Thought: Kepler to Einstein, Cambridge: Harvard University Press.
11. Lewalski, Barbara: (1992), Writing Women in Jacobean England, Cambridge, Mass: Harvard University Press.
12. Piramida e Diellit është struktura e tretë më e madhe antike në botë pas Piramidave të Gizës në Egjipt dhe Piramidës Cholula në Meksikë. Kulmi i frekuentimit turistik bie në ditën e ekuinoksit të pranverës. Ka një shpjegim për këtë. Vërtetë, është nga kategoria mistike. Gjatë ekuinoksit të pranverës, njerëzit që vizitojnë Teotihuacan ngjiten në shkallët e Piramidës së Diellit dhe kthehen të përballen me Diellin me krahë të hapura. Shumica e pjesëmarrësve në ritual besojnë se në këtë moment çlirohet energjia hyjnore e fshehur në piramidë. Shumë vizitorë pretendojnë se në këtë moment ata ndiejnë një ndjenjë paqeje dhe harmonie me botën përreth, në: Hammond, Norman: (1988), Ancient Maya Civilization, New Brunswick: Rutgers UP.
13. Rosenau, Pauline; (1992), Post-Modernism and the Social Sciences, Princeton Iniversity Press, Londër.
14. Sarup, Madan: (1993), Poststrucralism and Potsmodernism, Great Britain, Ashford Colour Press Ltd, Gosport, Hampshire.
15. Turner, Mark: (1998), The Literary Mind: The Origins of Thought and Language, New York: Oxford University Press.
16. Vickers, Brian: (1988), In Defence of Rhetoric, Oxford: Clarendon Press.
17. Wainwright, Jeffrey: (2004), Poetry, the basics, New York: Routledge.
18. Walker, Thomas: (1996), Postmodernism and the study of the future, Futures Research Quarterly.
19. Zhiti, Visar: (2010) Panteoni i nëndheshën ose letërsia e dënuar, "Omsca -1", Tiranë.



mërgimtarit të largët me mungesën dhe mallin, me kujtimet dhe miqësitë, atdheu i tij mpaket tekta pengesat lartohen prore, kufijtë e hapësirës (dhe kohës), ku gjetnojnë simbolet letrare, rroken shumë simbolika (Ferber: 1999), nëpërmjet (tej)optikave:

– (tej)optika e jetës / vdekjes nag vargjet: *dikur u lodha duke shëtitur i vdekur / dhe vendosa të vij në Meksikë*

– (tej)optika e botës shtazore (qentë, lopa), vargjet: *ndërrohet pyetja / si ju duket Meksika / (qeni me prejardhje të ujkut ilir / e ul pak bishtin / vetëm pakëz)*, f.117

– (tej)optika e marrëdhënies atë-bir, nëpërmjet vargjeve: *edhe babai mbillte pemë në kopsht / thoshte fëmijët e tu do t'i hanë / Herën e fundit kur isha në Kosovë / motra m'i futi dy kokrra mollë në valixhe / pa e ditur unë / në aeroportin e Meksiko Sitit u alarmuan*, f. 133.

simbolika biblike e tradhtisë së Judës (kundër Jezusit), simbolika e tradhtisë dhe arratisja nga atdheu, por gjeli / këndezi (në gjuhën popullore) lajmëron prishjen e motit, kurse dielli tek majat është Piramida e Diellit (Hammond: 1988) .

• pjesa e shtatë: (*"Rruga që kurrë nuk humbet"*) me njëzeteshtatë (27) poezi, gjithëroket siç është hermetizmi, modernizmi dhe postmodernizmi, duke e transformuar tekstin si nëntekst, nga rrëfimi mitik në rrëfim letrar, që lidhet edhe me mitokritikën (Brunel: 1992), duke medituar për botën, atdheun, dhimbjen, vetminë dhe njeriun duke shpalosur imazhe lirike, si poezi spontane mes vetëdijes dhe (pa)vetëdijes, si mënyrës e konceptimit të realitetit brenda poetikës së receptimit, jo vetëm drejt një poezie të përjetimit por edhe të receptimit, të dikotomisë së gjuhës dhe realitetit të dëshirës dhe mundësisë, përtej

kombinim perfekt për të kuptuar forcën, kumtin përçues tek lexuesit e poezisë së Xhevdet Bajrajt, jo vetëm si strukturë individuale poetike por edhe si strukturë psikologjike (Holton: 1973).

Si përfundim: poezia është një poezi e ndërtuar mbi teknikat e poetëve dhe shkrimtarëve të realizmit magjik, me shtresëzime edhe të elementeve të tjera, një poezi që diellnon nga kulti i diellit të Majave, një kulturë shumëshkolllore që akoma gjallnon duke frymëzuar shumë poetë të njohur. Por specifika e ndërtimit të poezisë së shqiptarit Bajraj, është një mistikë më vete, që i qaset dhe i largohet lexuesit shqiptar, por i panjohur nga lexuesit bashkëkohës, që qëllimisht është lënë në hije, pse jo në *harresë totale*, por është edhe faji i kritikës që "lajkaton" deliret e militantizmit të politikës me zhveshjen nga çdo vlerë poetike kulturele dhe njerëzore.



PASCAL BRUCKNER

Laboratori i Serbisë për fabrikimin e historisë

PROPAGANDA SERBE E VIKTIMIZIMIT

Kapitulli i gjashtë Pafajësia e torturuesit: viktima në propagandën serbe i librit *The Temptation of Innocence: Living in the Age of Entitlement*, botuar më 2000 në Nju-Jork nga *Algora Publishing*. Përzgjedhur dhe përkthyer nga Rexhep Maloku

(Marrë nga numri i 11-të i revistës për letërsi, kulturë, gjuhë, media, "Akademia")

"Ditën kur krimi mëveshët me pafajësi, me një përmbajtje kureshtare që është specifike për kohën tonë, është pafajësia ajo që duhet ta justifikojë veten" - Albert Camus, "L'Homme révolté"

"Duke mos qenë të zotë t'i fuqizojmë të drejtën, ia kemi dalë t'i bëjmë të drejtë të fuqishmit" - Pascal, "Pensées"

"Ne jemi hebrejntë e botës në fund të shekullit të njëzetë. Jerusalemi ynë i dashur po kërcënohet prej të pafeve. Krejt bota na urren; armiku i paqëndrueshëm, një hidër me njëqind koka është përbetuar që të na shkatërrojë. Të gjithë fëmijët tanë tashmë mbajnë yllin e verdhë të padukshëm të qepur në rrobat e tyre. Jemi ne ata që kemi vuajtur gjenocidin më të keq se ai që ishte kryer nga nazistët kundër

hebrejve dhe jevgjëve, dhe bash si hebrejntë, edhe ne duhet ta nisim shtegtimin nëpër shkretëtirë, edhe në qoftë se do të zgjasë pesë mijë vjet". Prej gojës së kujt dalin këto fjalë? Ndonjë lideri të ekzaltuar mesianik, prej kreut të ndonjë kulti protestant fundamentalist që matet me judaizmin për përpikërinë e Biblës? As që bëhet fjalë!

Deklarata të tilla janë thënë përditë, në një formë a tjetër, për vite me radhë prej partizanëve të regjimit të Millosheviqit në Beograd. Novelisti Dobrica Q osiq, kryefrymëzuesi i nacionalizmit serb dhe president i Jugosllavisë së re (Serbia dhe Mali i Zi), deri në qershorin e vitit 1993 shkruante se serbi "është hebreu i ri, në fund të shekullit të njëzetë - viktimë e të njëjtave padrejtësi, nëse jo e të njëjtave persekutime: populli i ri martir". Por serbët janë më hebrej se vetë hebrejntë, thënë të vërtetën, meqë kanë qenë "viktima të gjenocidit që i kapërcente përmasat e gjenocideve naziste për nga metoda dhe egërsia", siç shkruante Qosiq në lidhje me politikën e shfarosjes së ushtruar prej ustashëve kroatë kundër bashkatdhetarëve të tij ndërmjet viteve 1941 dhe 1944.

Lufta që shkatërroi territorin e

ish-Jugosllavisë që nga viti 1991 dhe që ishte paramenduar prej Beogradit, u bazua mbi një keqinterpretim fantastik: Torturuesi e shfaqte veten si martir dhe Evropa, në pajtim me torturuesin, i paraqiste ata që sulmoheshin (kroatët, boshnjakët, shqiptarët e Kosovës) si përgjegjës për tragjeditë që u kishin rënë mbi kokë. Nëse u dilte ndonjë problem, thuhej se e kërkuan të zezën - ishin ata fajtorët! Pse ky gabim tmerrues, pse pothuajse për një vit, intelektualët, politikanët dhe gazetarët perëndimorë, kishin ngrënë karremin e propagandës serbe. Dhe si mundet një person aq i informuar, si Francois Mitterrandi, të deklaronte më 29 nëntor 1991 (në një intervistë për "Frankfurter Allgemeine Zeitung" pikërisht në kohën kur qyteti i Vukovarit porsa ishte djegur rrafsh me tokë dhe kur çereku i territorit kroat kishte rënë nën kontroll të ish-ushtrisë federale), se "Kroacia, e jo Serbia, i përkiste bllokut nazist?" Sepse Millosheviqi dhe besnikët e tij ishin aq të zgjuar që ta pushtonin opinionin publik dhe ta justifikonin luftën para se ta nisnin me shkrime propaganduese për fatkeqësitë që gjatë historisë i vuajti populli serb. Duke shfaqur përherë fotografi dhe xhirime të

grave, fëmijëve dhe pleqve të masakruar, të nëpërkëmbur dhe të torturuar, apo duke cituar pafundësisht nëpër debate dhe takime listën e atyre që vdiqën në Jasenovac (një prej kampeve më të tmerrshme të përqendrimit të regjimit kroat nën Ante Paveliqin pro-nazist, ku hebrejntë, jevgjit, partizanët serbë dhe kroatë u shfarosën me mijëra sish), kjo propagandë siguroi terren të gjerë moral, dhe që nga fillimi ia zuri frymën kujtdo që mund ta vinte në dyshim: Shiko vuajtjen time dhe guxo të më thuash se është e barabartë! Ky është një rast studimi që na mjugulloi njohuritë për konfliktin dhe u bë burim prej të cilit më vonë rrodhën gjykimet e gabuara: indiferenca, hezitimi dhe politika pritëshih e Evropës dhe Amerikës.

Andaj, sunduesit serbë, para se ta lansonin ofensivën e tyre në Kroaci dhe Bosnjë, tashmë e kishin fituar betejën e mendjes, tashmë u ishte shprehur një nivel i caktuar dashamirësie prej bashkësisë ndërkombëtare. Kjo shpjegon pse Beogradit, si pak pushtues në historinë e re, nuk i ishte prerë rruga; pse Beogradi ishte favorizuar me tezat e tij të diskutuara, të komentuara, të dëguara dhe të vlerësuara me vëmendje të madhe; pse gëzonte

këtë lloj privilegji. Dokumentarë, shkrime dhe raporte të panumërta ishin publikuar prej vitit 1991, me hollësi për krimet e kryera gjatë Luftës së Dytë Botërore prej kroatëve, boshnjakëve dhe shqiptarëve, të cilët i ishin bashkuar regjimit nazist - megjithëse mbledhja e këtyre tmerrre do t'i kompensonte disi tmerrret e kryera gjatë të njëjtës kohë prej milicisë së Beogradit. Pa dyshim, pas një viti u hoq dorë prej kësaj preference ekskluzive për serbët. Por, me qëllim të shmangies së sprapsjes së menjëhershme, ministrat e jashtëm shpikën fabulën tjetër: se të gjitha kampet ishin njëjtë të tmerrshme. Andaj triumfoi parimi i baraslarguar: gjërat nuk ishin vënë në perspektivën e tyre të duhur, por të gjitha palët ishin përfshirë në vllugun e njëjtë të egërsisë tribale. Dhe në maj 1993, në lidhje me ngjarjet në Bosnjë, Warren Christopher dha këtë deklaratë konfuze para Kongresit: "Do të ishte e lehtë të krahasohej e gjithë kjo me Holokaustin, por unë kurrë nuk kam dëgjuar asgjë për ndonjë gjenocid të kryer prej hebrejve kundër popullit gjerman". Shumëkush edhe sot vazhdon të gjejë rrethana justifikuese për nacionalizmin

serb dhe nuk mund t'i qaset kësaj teme pa rënë menjëherë në grackën e përbaltjes së kroatëve, boshnjakëve, sllovenëve, shqiptarëve dhe maqedonasve.

Dhe mashtrimi ka funksionuar. Hipnotisti serb, duke kërkuar shfaqjesimin e madh për krimet e tij rrëqethëse, mjaftonte të maskohej si viktimë që të falej. Ku kemi gabuar ne me krizën jugosllave? Njëjtë, si me gabimin e përrjetshëm që e bëme me komunizmin dhe me përkrahjen tonë për Botën e Tretë: Ia kemi lejuar vetes të shantazhoheshim prej retorikës së viktimit. Leksioni i tmerrshëm i shekullit është kjo sprapsje që transformon të shtypurit, me të marrë pushtetin, në diktatorë, që transformon proletarët në tiranë, të kolonizuarit në sundues të rinj. Nuk i vret ndërgjegjja ata që ishin persekutuar. Dhe njerëzit prej të cilëve prisnim drejtësi dhe barazi, në fakt sundojnë me despotizëm, që është edhe më frikësuese meqë ata erdhën në pushtet me aspiratat për liri dhe drejtësi. Është kjo formë përmbysjeje, sepse nuk jemi të zotë ta përthekojmë - sikur të ishte e shkruar njëherë e përgjithmonë se nëse dikur ishte viktimë, përherë viktimë do të mbetesh. Kështu nuk rrezikon që të rrëshqasësh në dhunë dhe totalitarizëm. Kjo ishte fuqia e propagandës së Millosheviqit (përveç - ose për shkak të - aspektit të saj fantastik, së cilës ia ka bashkëngjitur edhe traditën e folklorit sllav). Ai kujton të gjitha të zezat që i ka vuajtur populli i tij, sidomos ato ndërmjet viteve 1941 dhe 1945, i japin imunitet të përhershëm, duke e vënë veten mbi ligjin. Nuk ishte asgjë më dekurajuese se të shihje se si ky kurth po pranohej dhe përprihej prej publikut (dhe shpesh në emër të vigjilencës strikte demokratike).

Pakkush, së paku në fillim, e kuptoi se po këta njerëz që shfaqeshin si rezistues të fashizmit, (serbët) kishin huazuar tashmë metodat e fashizmit, se ujku ishte futur në lëkurën e qengjit; pakkush e kujtonte se ideologjia viktimizeuese ishte pjesë e fashizmit, që nuk është vetëm doktrinë e racës më të lartë, por e një race më të lartë të poshtëruar. Kështu, me shkathtësi të patëmetë, ekstremistët serbë ia dolën në krye me maskimin e apetitit të tyre për pushtim si shqetësim për mbrojtjen e pakicave të tyre, vullnetit të tyre luftëdashës si dashuri për paqen, spastrimin e tyre etnik si dëshirë të zjarrtë për ruajtje të Federatës Jugosllave. Me pak fjalë, më së miri e përmbledh proverbi: "Edhe djallit i pëlqen ta citojë Biblën".

Çka është për serbët identiteti viktimizeues? Është traditë e brumosur prej letërsisë dhe Kishës Ortodokse, dhe ka lëshuar thellë rrënjët në historinë e kahershme të vuajtjes, prej kohës së kolonizimit turk dhe sistemit feudal habsburg, që gjeneruan patriotizëm të ekzagjuar, e që

nxiti veprime dramatike heroizmi. Është ndjenjë e pasigurisë së përhershme të krijuar prej dyndjeve të përhershme dhe ndryshimeve kufitare, shpërnguljeve zemëruese dhe ekzilit të shtetasve që ishin larguar nga territoret armiqësore. Dhe fundja është element i trashëguar që ka marrë hov prej disfatës së Princit Lazar më 15 qershor 1389 para osmanëve në Betejën e Kosovës ("Fushës së Mëllenjave"), ngjarje historike, trashëgimia e së cilës kujtohet për shekuj me radhë. Serbët ishin para fatit të lavdishëm - duhej të ishin ndërtuesit e mbretërisë së re bizantine, por gjithçka u rrëshqiti prej duarve. Sot trashëgimtarë të nëpërkëmbur të një perandorie, që kurrë nuk ekzistoi, nuk pajtohen kurrsesi me humbjen. Ka krenari, madje edhe bukuri në mënyrën e festimit të disfatave të tyre, meqë Zoti paska zgjedhur pikërisht këtë popull për ta sprovuar me fatkeqësi dhe për ta bërë instrument të qëllimeve të tij, si të ishte e shkruar që debakli tokësor të transformohej përherë në triumf qiellor karshi forcave të djallit. Serbët duket se nuk ndihen të helmuar prej të këqijave prej të cilëve janë prekur, dhe ata kultivojnë, sidomos në poezinë e tyre epike, ekzaltimin e këtyre gjykimeve, duke besuar pathyeshëm në martirizimin e tyre.

I gjithë populli është mishëruar me bindjen se e ka të shkruar të vuajë dhe se është pasardhës i këtij soji të dinjitetit aristokratik: sikur shihet me aq nënçmim, keqtrajtohet prej zanafillës, e kjo mund të jetë vetëm punë e Zotit!

Prej ardhjes në pushtet, Millosheviqi u është përshtatur anktheve të bashkatdhetarëve, duke rizgjuar të kaluarën e paraardhësve për ta përdorur për planin politik dhe ushtarak për Serbinë e Madhe. (Serbia e Madhe, na lejoni që t'ju kujtojmë, nuk nënkupton veç bashkimin e të gjithë serbëve në një shtet. Ajo, gjithashtu, nënkupton që është edhe më e rëndësishmja, dëbimin e të gjithë joserbëve nga ai shtet). Ky obsesion me vajtim, vdekje dhe zhdukje, i krijuar me përsosmëri në vetvete, shihet përherë e më me dyshim kur përdoret prej një lideri të një shteti dhe transformohet në armë ideologjike për legjitimimin e luftës. Andaj, Serbia e Millosheviqit, kah fundi i viteve 1980, ndiente se nuk ishte lënduar aq shumë prej padrejtësisë së situatës ekonomike që kishte ardhur si pasojë e aventurave të gabuara të Luftës së Dytë Botërore dhe ndrydhjes së Jugosllavisë, por prej një padrejtësie qenësisht metafizike që rrënjët i ka në historinë 1000-vjeçare. Në këtë aspekt, komunizmi nacional serb është hibrid interesant: prej nacionalizmit ekstrem huazon obsesionin karshi gjakut të përzier (temë e përsëritur në romanet e Dobrica Qosiqit) fobinë karshi mosndëshkimit dhe nevojën urgjente për ndarje, për ta ditur

kush çfarë është. "Zemra dhe identiteti ynë", deklaronte Karaxhiqi, lider i serbëve të Bosnjës, "mund të mbijetojnë vetëm nëpërmjet ndarjes. Nuk mund ta përziesh ujin dhe naftën. Ballkani nuk është si Zvicra ose Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Tenxherja me presion asnjëherë nuk ka funksionuar, pavarësisht prej pushtuesve të huaj të njëpasnjëshëm". Komunizmit ia huazoi stilin, pretendim që mendohet se buroi prej trashëgimisë së vjetër kulturore, siç e kemi parë. Ky mishmash i tmerrshëm mjegulloi vizionin e antifashistëve tanë më të mprehtë: ky nuk është nazizëm - Millosheviqi nuk është Hitleri dhe spastrimi etnik nuk është zgjidhja përfundimtare - as stalinizëm i sertë, por produkt i çnatyruar i martesës së tyre të fundit kombinuar me fasadë pluraliste dhe ekonomi mafioze. Kjo është arsyeja pse kokteji serb mund të përdoret si precedent për popujt që së fundi kanë dalë prej komunizmit; fuqia e saj joshëse buron prej kombinimit të dy lëvizjeve (që përdoreshin për t'u matur njëra me tjetrën) në luftë kundër armikut të tyre të përhershëm: demokracisë liberale. Çifton metodat staliniste me lartësimin e krisur të identitetit, zmadhuar dhe ekzaltuar në pastërtinë e vet, kundrejt kontaminimit dhe ndërshumëzimit. Dhe, mbi të gjitha, u ofron politikën e poshtërimin vendeve që nuk ndihen se janë zotë të tyre dhe për të cilat pavarësia është vetëm themel i lëkundur. U tregon atyre se si në emër të fatkeqësive të së djeshmes, ta fabrikojnë shenjën dalluese që i bën të paprekshëm, që i shkarkon prej borxheve dhe, për më tepër, u jep patentën për të urryer dhe ndëshkuar sipas tekeve të tyre.

Sidoqoftë, Serbinë e vogël e ndjek përherë hija e Rusisë, e cila është e lidhur me Serbinë me nyje fetare, emocionale dhe etnike - hija e një harku të ri ortodoks pansllav. Për krejt ata në Moskë dhe kudo qofshin në rrënoja të

perandorisë sovjetike që ëndërrojnë hakmarrjen kundër Perëndimit dhe që ndihen të poshtëruar, Serbia e Millosheviqit ofron modelin e suksesshëm për komunizëm mahnitës. Këtu ka rrezik se banon e vërteta. Gjynahu i regjimit të Beogradit nuk bazohet edhe aq shumë në shprehjen e qëllimeve që mund të jenë legjitime - të gjitha ish-republikat jugosllave ishin të pakënaqura me fatin e tyre, por për faktin se ka zgjedhur t'i korrigjojë ato nëpërmjet dhunës dhe spastrimit etnik, duke shkelur kështu zotimin e madh mbi të cilin Evropa moderne e ndërtoi veten: ndalimin e luftës. Kurrë më pushtimeve, shkatërrimit masiv, shfarosjes në kontinentin tonë - i tillë ishte pakti që lidhi që nga viti 1945 shtetet e Evropës Perëndimore dhe që ka qeverisur pajtimin franko-gjerman. Prandaj, mosmarrëveshjet tona duhet të zgjidhen me dialog dhe arbitrazh, e jo me armë. "Laboratori jugosllav" (Roland Dumas) ka rihapur "kutinë e Pandorës": prospektin e modifikimit me forcë të kufijve. Duke besuar se do ta blejë paqen duke copëtuar Bosnjën, Evropa vetëm inkurajon luftën si mjet për zgjidhjen e problemeve. (Ndërhyrja brutale e Moskës në Çeçeni nuk do të ndodhte pa Vukovarin dhe Sarajevën). Fundja, Evropa autorizon përsëri krimet kundër njerëzimit si instrumente të pushtimit në oborrin e saj.

Gjenocidi si retorikë në propagandën serbe

Nuk është qëllimi që të hidhen poshtë përmasat e masakrave të kryera prej ustashëve nga viti 1941 deri më 1945 (që ishin të tmerrshme, por ishin kryer vetëm me aprovimin e një pakice të popullsisë kroate) dhe terrorin që e mbolli në zemrat e popullit serb. Kroacia e Paveliqit mbetet pas Gjermanisë naziste, "regjimi më i përgjakshëm i gjithë Evropës hitleriane. As Italia fashiste, e as Franca e Vichyves, apo Sllovakia, Hungaria ose Rumania nuk

përjetuan diçka të ngjashme".

Në këtë sens, një prej gabimeve të presidentit Tugjman, në momentin e pavarësisë së Kroacisë, do të ishte mosofrimi i kërkimfaljes solemne serbëve për regjimin e Paveliqit; ai nuk shkoi (qysh bëri Willy Brandt, ta zëmë, kur shkoi në geton e Varshavës) të përulëj në gjunjë në Jasenovac, që t'i siguronte se Kroacia e re nuk do të prodhonte më urrejtje të tillë. Një gjest si ky nuk do ta çarmatoste fare agresivitetin e Beogradit, por do të kishte ndikim të menjëhershëm simbolik - do të vërtetonte se republika e re, në anktë për t'iu bashkuar Evropës, po zgjaste dorën për pajtim dhe drejtësi. (Franjo Tugjmani priti deri më 15 janar 1992 që t'i dënonte vrasjet masive të hebrenjve nga ana e ustashëve - nëpërmjet një letre dërguar Edgar Bronfmanit, kryetar i Kongresit Botëror të Hebrenjve. Si autor i një libri ku shkruan edhe për gjenocidin, Tugjmani, përveç kësaj përsëriste, në disa raste gjatë fushatave të tij zgjedhore: "Fatkeqësisht, gruaja ime nuk është e aserbe e as hebraike". Ai e justifikonte veten për librin e tij "negacionist" në një letër dërguar në shkurtin e 1994-s kryetarit të "American B'nai B'irth". Qysh ndodh shpesh në raste të ngjashme me të, vjen në shprehje qasja dashamire, por shumë e vonshme, për t'i shlyer gabimet trashanike që çojnë gjithçka në fund të pusit.

Sa për kujtim, gjenocidi i ngjallur gjithnjë prej ekstremistëve serbë, është burim i pashtershëm urrejtjeje, hakmarrjeje dhe zemërimi. I mishëruar me fatin e keq që i dallon, këta ekstremistë kanë alamet sysh: ata nuk pretendojnë vetëm një, por tri gjenocide të kryera kundër serbëve vetëm në shekullin njëzet. Andaj, njëfarë Petar Milatović Ostroski, shkrimtar serb që mbron vendin e tij prej "komplotit ndërkombëtar", beson me mendjen top se "populli serb në shekullin njëzet ka qenë viktimë e tri valëve të gjenocidit të kryer prej kroatëve". I pari ndodhi nga viti 1914 deri më 1918, i dyti gjatë shtetit të pavarur të Kroacisë, dhe i treti qysh prej inaugurimit të Franjo Tugjmanit, gjeneral i Titos dhe historiani i Paveliqit. Për turpin



më të madh të serbit, ky gjenocid po vazhdon edhe sot. Por Petar Milatović Ostroski në çmendurinë e tij të madhe harroi edhe një tjetër gjenocid: gjenocidin e serbëve për nënshtrimin e shqiptarëve të Kosovës. “Gjenocidi fizik, politik dhe kulturor i popullsisë serbe të Kosovës dhe Metohisë është disfata më e madhe që ka vuajtur Serbia në luftën e saj për çlirim prej betejës së Orashacit më 1804 deri në kryengritjen e vitit 1941”; kështu shkruhet në Memorandumin e Akademisë së Shkencave të vitit 1986, dokument i bazuar kryekëput në idetë e Dobrica Qosiqit, dhe ku thuhet se ka frymëzuar “Revolucionin kulturor” të Millosheviqit.

Prej një gjenocidi të vërtetë, të kryer prej ustashëve kroatë, gjuha zyrtare e gdhendur zgjeron këtë shprehje gjerë e gjatë që të mbulojë çfarëdo proteste a sfide ndaj politikave serbe. Në janar 1994, njëfarë Daniel Schiffer, “filozof” dhe propagandist që jeton në Evropën Perëndimore dhe që përfaqëson regjimin e Beogradit, akuzoi intelektualë të caktuar francezë për tradhti të re në qasjen e tyre kur vjen puna te Serbia.

“Shumica dërmuese e intelektualëve francezë i kanë bërë gjenocid moral Serbisë, praktikisht një linçim të pastër dhe të thjeshtë kulturor (nëse jo edhe shpirtëror), sikur çdo serb në fakt të ishte nazist potencial”.

Se antiserbizmi mund të jetë vetëm avatar modern i antisemitizmit, sugjeron përsëri Daniel Schiffer, duke apostrofuar ndërmjetësit e tij: “Me mënyrën tuaj shpesh të helmët, me të cilën ju vazhdoni t’i akuzoni vetëm serbët, duke jua marrë mendja se po ngriheni kundër krimit, vetëm sa e keni shpikur në sytë e opinionit publik ndërkombëtar një soj të ri racizmi: një antiserbizëm, si antisemitizmi që ekzistonte në vitet 1940, në kohën e baballarëve tanë”.

Dhe më 1991, shkrimtari serb Milorad Pavić shkruante se “në këtë moment serbët në Jugosllavi janë edhe një herë në listat për gjenocid qysh ishin serbët dhe hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Por është hera e parë që serbofobia në Evropë, por edhe në mbarë botën, është më e furishme se antisemitizmi”. Çfarë nuk është gjenocid për serbët, ju pyes juve? Kritikizmi më i vogël, rezervimi më i vogël që po tregohet ndaj dimensioneve të një krimi total; ekzagjerimi i fantazuar që shkatërron ndikimin e fjalës duke e mohuar në pafundësi. Nëse kritika kundër Millosheviqit e bën dikë të ndihet fajtor për “gjenocid”, atëherë kjo duhet të jetë fjala më e lehtë që duhet përdorur me kujdesin më të madh, duke rrezikuar t’ia hupë krejtësisht kuptimin. Sundimtari serb shihet qartazi se nuk është përgjegjës për zhvlerësimin e këtij termi: ky abuzim gjuhe është i rëndomtë ndër të gjitha palët në Ballkan, ku ka prirje të përdoret për t’i përshkruar tensionet ndërkombëtare, por edhe këtu në Perëndim, qysh e kemi parë, përdoret e stërpërdoret gabimisht. Vetëm na lejoni të theksojmë



thjesht se për pasuesit e Millosheviqit, kushdo që i kundërshton, është “nazist” dhe çfarëdo orvatje për t’iu kërkuar llogari, mund të përshkruhet si “gjenocid”. Duke iu adresuar përfaqësuesve të shteteve në Gjenevë, njëherësh duke protestuar kundër sanksioneve kundër Jugosllavisë më 9 dhjetor 1993, Millosheviqi deklaronte: “Kur të vijë dita që fëmijët tuaj ta mësojnë të vërtetën, nuk e di se si do t’ua shpjegoni se pse vratët fëmijët tanë, pse kallët luftën kundër tre milionë fëmijëve tanë dhe me çfarë të drejte i shndërruat dymbëdhjetë milionë banorë të Evropës bazë për gjenocidin, shpresoj, gjenocidin e fundit në këtë shekull”.

Andaj, anatema shndërrohet nëpërmjet procesit të shtrembërimit tragjik në klishe retorike, në propagandë, formulë që ka funksionin e thjeshtë të çarmatosjes për kundërshtimet e mundshme dhe të sugjerimit se: ju na keni borxh gjithçka për shkak të të gjitha të zezave që i kemi vuajtur; ju nuk mund të na refuzoni. Ideja se krejt bota i ka borxh një grupi dhe vendi të tillë dhe se duhet t’u hapet rrugë të kryejnë çfarë të zezash, është e njohur dhe e lidhur fort me ekstremistin rus Zhirinovsky.

“Rusia në të kaluarën e shpëtoi botën prej Perandorisë Osmane me dërgimin e ushtrive të saj në jug. Mbase, po të mos ishte Rusia, e gjithë Evropa do të turqizohej, turqit do ta merrnin Budapestin, do ta rrethonin Vjenën dhe do t’u mbetej vetëm një copë udhë e shkurtër prej aty deri në Berlin, Paris dhe Kanalin Anglez. Shtatë shekuj më parë ua premë rrugën mongolëve. Mund t’u hapnim turqve udhë ose mund t’i nënshtroheshim dominimit të tyre. Çfarë do të mbetej atëherë prej Evropës? E kemi shpëtuar disa herë; në jug, në lindje dhe në veri kur hataja fashiste po triumfoje në Gjermani, Itali, Portugali, Spanjë e Greqi. Falë rusëve, Evropa u çlirua nga fashizmi... Popujt e tjerë duhet të tregohen mirënjohës ndaj rusëve për këtë punë”.

Dhe ministrja aktuale greke e Kulturës, Melina Mercouri, në hall të madh që ta mbrojë me forcën bindëse kundërshtimin e Athinës për njohjen e Maqedonisë, ka deklaruar gjithashtu më 6 janar 1993 se Evropa “duhet t’ia shlyejë

borxhet e veta Greqisë”, “evropianët kanë detyrime ndaj nesh” se paska qenë Greqia që ua dha atyre “idenë fillestare të demokracisë dhe rrënjët e zhvillimit të civilizimit të tyre”.

Me pak fjalë, sa herë një shtet ose një popull dëshiron ta vërë veten mbi ligjin, me vetëdije të plotë kujton veprat e mëdha dhe vuajtjet e kaluara për të pretenduar heshtazi se meriton këtë përjashtim të vogël në raport me standardet ndërkombëtare.

Mbledhja e gjenocideve sikur të bëhej fjalë për mbledhje diplomash, afërmendsh se e bën të mundshëm krahasimin ndërmjet serbëve dhe hebrenjve, krahasim i bazuar në të zezat që i vuajtën të dyja palët në kampet e përqendrimit të ustashëve. Sidoqoftë, do të mjaftonte një kërkim i vogël në histori për t’i dëshmuar cenet në këtë analogji. Duhet të kujtojmë, ta zëmë, se në Jugosllavinë e pushtuar të vitit 1941 kishte një qeveri serbe që bashkëpunonte me pushuesit gjermanë (prirë prej Milan Nediqit, “Pétainiserb”), dhe se prej 5 tetorit 1940 - që është goxha shumë kohë para mbërritjes së Wehrmachtit - kishte një ligj me një numër nenesh për çmimin e pranimi të hebrenjve në kolegji dhe universitet, dhe që ua ndalonte të merreshin me fusha të caktuara të tregtisë, thënë troç ua kufizonte të drejtat; se para luftës, kishte një parti fashiste të Lotiqit, që më vonë organizoi trupat e vullnetarëve serbë, detyra e të cilave ishte mbledhja e hebrenjve, romëve dhe partizanëve për ekzekutim; se më 22 tetor 1941 në Beograd (nën zgjedhën naziste) u hap ekspozita e madhe antimasonë, ku denoncohej komploti komunist dhe judeo-masone për ta dominuar botën - ekspozita u konsiderua si goxha e suksesshme; se gjatë pushtimit, kërret ortodoksë (ndryshe prej klerit katolik të Kroacisë) urdhëruan pagëzimin e dhunshëm të katolikëve dhe myslimanëve, por hebrenjve ua ndaluan konvertimin, rrjedhimisht duke i dorëzuar te makineria gjermane e shfarosjes; se zgjidhja përfundimtare (dhe futja e fëmijëve dhe grave të para në dhomat e gazit) kishte nisur dhe mbaruar në Serbi falë bashkëpunimit aktiv të

autoriteteve lokale, klerit, Gardës Kombëtare dhe forcës policore serbe, që i priu likuidimit të bashkësisë hebraike të Serbisë; dhe në fund, në gusht 1942, doktori Harald Turner, drejtor i administratës civile naziste të Serbisë, deklaronte se ky shtet ishte i vetmi ku ishin zgjidhur “çështja hebraike dhe çështja rome”.

Kjo nuk e cenon aspak faktin se serbët ishin ndër të parët që rezistuan, me Titon, qysh e ka pranuar edhe vetë publikisht; e që njëherësh nuk shlyen apo zbut assesi urrejtjen e Shtetit të ustashëve; por që ia jep identifikimin automatik të paqartë, nëse jo të dyshimtë, për çështjen e hebrenjve, por që nacionalistët e Beogradit turren menjëherë ta përvetësojnë si pretendim.

Në Serbi, si kudo tjetër në Evropë, kishte një traditë të fortë antisemite, që është e tillë edhe sot, së paku e fshehur prapa klerit ortodoks, megjithëse shumë serbë pësuan fatin e hebrenjve kundrejt nazistëve gjatë kohës së luftës, ani pse bashkësia e vogël hebraike, që ka mbetur në Beograd, nuk përballet absolutisht me asnjë kërcënim (jo me kërcënim më të madh se mund të ndiejë në Zagreb), meqë të dyja palët u bënë mjaftueshëm kurban sa për të mos rënë kurrë në këtë kategori.

Hebrenjtë si rivalë dhe model i serbëve

Bash si antisemitizmi që ia mori për pak anën synimit të vet me judaizimin e “johebrenjve” në vendet ku ishin zhdukur të gjitha gjurmët e pranisë hebraike, ose ku ishin reduktuar në një grusht njerëzish - qysh ka ndodhur me shumë popuj dhe grupe - dëshira për të qenë hebrenj në vend të hebrenjve shndërrohet përmjetherë në diçka konkurruese derisa njerëzit luftojnë ta marrin privilegjin e të qenët popull i zgjedhur.

Në përgjithësi, mund të shquhen dy soje të mëdha të

antisemitizmit: fetar, me frymëzim të krishterë, që akuzon popullin e Moisiut për vrasjen e Krishtit, dhe që ngulmon në gabimin e tyre pas shpalljes evangjelike; dhe ai nacionalist, që denoncon pakicat të pashtet, si burim të mosndëshkimit që, në fakt, është paragjyqese për qenien e kombit. Një i tretë, trend më befasues antisemitizmi, u është shtuar këtyre kundërshtimeve tradicionale në gjysmën e dytë të shekullit njëzet: zilia ndaj hebretut si viktimë, modeli i përkryer i fatit të keq. Kështu, hebrenu shndërrohet në model dhe pengesë njëherazi, uzurpon pozicionin e popullit që meriton të gjitha të drejtat që u atribuohen zezakëve, palestinezëve, serbëve, rusëve, polakëve, ato të drejta që burojnë prej revolucionit francez e të tjera.

Tradicionalisht, pansllavizmi dhe pangjermanizmi (që janë imituar në këtë aspekt prej shumë nacionalizmave periferikë), ia atribuojnë vetes prejardhjen hyjnore, njëfarë lidhjeje speciale me Providencën, të vulosur prej provave dhe vuajtjeve; kjo zakonisht dizajnohet si mënyrë për shquarjen e vetes nga hebrenjtë.

Duke e konsideruar veten popull i zgjedhur, i mundësohet një grupi të paqëndrueshëm ose të shpronësuar ta transformojë syrgjynosjen në bazë për madhështi, për t’ia bërë vetes qejfin e investimit në vokacionin mesianik. Andaj Dostoyevsky, në Sllavofilinë e tij militante, e bëri përkohësisht Rusinë e Shenjtë Krisht të kombeve, me qëllim që të mund t’ia ringjallte të nesërmen madhësinë, dhe ngjashëm e shpjegon sot Radovan Karaxhiqi: “Serbia është krijesë e Zotit. Madhështia e saj matet me urrejtjen e armiqve të saj” (mars, 1994).

Nuk ka rëndësi që kjo mistikë fisnore i ka rrënjët në një gabim në Bibël, ku zgjedhja është barrë që Zoti ia transmeton Moisiut dhe popullit të tij - për ta rrënjosur humanizmin, meqë judaizmi ka “sovrانيتet moral”, “përgjegjësi që një komb të mos devijojë”, ndërkaq në këto ideologji është shndërruar në variant të ri të mendimit racist, mjet afirmimi i epërsisë së një grupi etnik kundrejt një tjetri.

“Serbët”, thekson Radovan Karaxhiqi, “janë popull superior në Ballkan”. Nëse populli ia mbush mendjen vetes që është i dalluar dhe i shquar prej Zotit, afërmendsh se e konsideron veten si racën më të mirë dhe i sheh fqinjët si popuj inferiorë, që qenkan ndryshe prej tyre, të tjerët doemos se janë më të ulët. Por në ekzaltimin e tyre metafizik, këto lëvizje nacionaliste pandryshueshëm “turren drejt pretendimit shekullar të hebrenjve në pretendimin e tyre” (Hannah Arendt).

Në njërën anë, pretendimi i tyre i përzgjedhjes hyjnore i sheh “hebrenjtë si rivalin e vetëm të tyre serioz”, “rivalët e tyre më fatlumë, më fatbardhët, sepse prej

këndvështrimin të tyre hebrejntë gjetën mjetet e ndërtimit të një shoqërie të sotit të ri, një shoqëri ndaj së cilës as përfaqësimi i dukshëm, e as konteksti politik normal nuk mund të shndërrohen në zëvendësim për kombin". Përveç kësaj, ky pretendim u fuqizua prej "qasjes besëtyte, një frike se, mbi të gjitha, mbase ishin hebrejntë dhe jo vetë ata që i zgjodhi Zoti, dhe të cilëve u ishte garantuar suksesi prej Providencës hyjnore. Kishte një element të pakënaqësisë absurde kundër një populli, i cili, druhej, kishte marrë garancinë e pakuptueshme arsyeshmërisht se do të shfaqej një ditë, pavarësisht prej të gjitha pengesave, si fitues përfundimtarë në historinë e botës".

Dhe asgjë nuk e ilustron më mirë këtë formë të urrejtjes ziliqare më mirë se deklarata e famshme e Hitlerit dhënë Hermann Rauschningut: "Nuk mund të ketë dy popuj të zgjedhur. Jemi ne populli i Zotit. Dhe s'ka tjetër".

Por prej Luftës së Dytë Botërore ka një tjetër arsye të madhe për kombet ose pakicat në vështirësi që të dëshirojnë ta marrin vendin e hebrejve: Vuajtja hebraike është shndërruar në standard referencë dhe Shoah në ngjarje kyç me të cilën ne gjykojmë dhe dënojmë krimet kundër njerëzimit.

"Viktimat e Auschwitzit", thekson Paul Ricoeur, "janë përfaqësuesit më të denjë në kujtesën tonë të të gjitha viktimave të historisë". Por nëpërmjet një keqinterpretimi themelor, ata që duan të jenë bartësit e rinj të yllit të verdhë nuk e shohin gjenocidin si kulmin e egërsisë, "që terron diellin" (Claude Lanzmann), por rastin e veçimit nëpërmjet fatkeqësisë, shquarjes, potencialit për të fituar imunitet ose papërgjegjësi të padiskutueshme.

Dhe kjo është arsyeja pse shprehja "holokaust" është keqpërdorur në mënyrë goditëse dhe tronditëse prej vitit 1945: duke qenë në gjendje të thuash se je objekt i një holokausti të ri, nënkupton kryesisht se po vë në pah qartësisht rastin tënd; gjithashtu nënkupton se vjedhjen e fatkeqësisë maksimale dhe shpalljen e vetes si pronarin e vetëm legjitim, duke i hequr qafe të gjithë pretenduesit e tjerë.

Në vend se të jetë katastrofë dhe paralajmërim për krejt njerëzimin, gjenocidi pastaj shndërrohet nëpërmjet procesit të konfiskimit në burim të përparësive të pakufizuara morale dhe politike, njëfarë çelësi magjik që jua lejon të gjitha format e abuzimit dhe jua fal edhe gabimet më të rënda.

Ta judaizosh veten, qysh kanë bërë ekstremistët serbë (nëse ka qenë e nevojshme edhe me deklarimin e vetes më hebrej se hebrejntë, të cilët nuk janë të vlefshëm si rol), ua siguron një situatë të pafavorshme për fitore, njëfarë vijueshmërie të përjetshme nderi për imoralitet. Kjo shpie drejt dykuptimësisë së teologjisë etnike që bazohet në

identifikim, në pasionin judeofil se duke brendësuar hebreun në vetvete, mund ta nxirrin veten në anën tjetër, si puna e dorashkave të këthyer mbrapsht.

Serbët shpesh qahen se janë djallëzuar, janë shkukur prej familjes së kombeve, dhe e shohin këtë urrejtje universale si justifikim a posteriori të luftës së tyre. Kanë të drejtë, sepse janë të vetëm kundër botës. Por të mos harrojmë se qysh prej vitit 1986 propaganda e Beogradit i është kushtuar njollosjes sistematike të popujve që ua kishin mësyre t'i mposhtnin: para së gjithash, të gjithë shqiptarët e Kosovës, këta "fashistë të neveritshëm", thënë me shprehjet e përdorura në Memorandum dhe "terroristë të egër", përdhunues të grave serbe.

Duke folur për luftën e zhvilluar prej shqiptarëve të Kosovës kundër serbëve që nga viti 1981, autorët e Memorandumit specifikojnë: "Kryengritja në Kosovë dhe Metohi pak para përfundimit të luftës, organizuar me bashkëpunim të njësiteve naziste më 1944-45, u shtyp ushtarakisht, por doli se nuk ishte shkelur edhe politikisht. Nën frymën e tanishme, maskuar me përmbajtje të re, zhvillohet me sukses të madh dhe është afër triumfit. Ne përfundimisht nuk kemi kryer njëherë e përgjithmonë punë me agresionin fashist, masat e gjertanishme kanë hequr vetëm shenjat e jashtme të këtij agresioni, ndërkohë që qëllimet e tij finale, të frymëzuara prej racizmit, janë fuqizuar përsëri" (cituar nga "Dialogues").

V. K. Stojanović, kryetar i Shoqatës i Shkencëtarëve dhe Profesorëve Universitarë të Serbisë, shkruante në një letër të hapur në numrin e 8 shkurtit 1990 në të përditshmen "Politika": "Sot terroristët e egër shqiptarë po vlojnë në Kosovë dhe në Metohi, duke sulmuar dhe shkatërruar gjithçka serbe, duke djegur shtëpi serbe dhe terrorizuar ata pak njerëz që kanë mbetur atje". (Cituar në "Le nettoyage ethnique", Fayard 1993, f. 286 të Mirko Grmeckut, Neven Simacut dhe Mark Djidaras).

E sa për kroatët, ata kanë qenë popull gjenocidal që katër shekuj, pretendon historiani serb Basilje Krestiq. Popull "i kalbur", sipas fjalëve të liderit ultranacionalist serb, Sheshel, i cili rekomandonte në një televizion serb që t'u pritëshin kokat "jo me thikë, por me lugë të ndryshkur", sugjerim që thuhet se ua kishte kërkuar nëpërmjet një letre milicisë së tij në Bosnjë dhe Kroaci. Fundja, myslimanët e Bosnjës dhe Sanxhakut janë "viktimat të frustrimeve të zorrës së trashë që i inkurajojnë t'i plaçkitin pasuritë dhe të prehen në sjelljet e tyre fanatike", janë fjalët e fuqishme të doktorit të psikiatrisë, Jovan Rashković, një tjetër teoricien i nacionalizmit

serb. Përveç kësaj, islami nuk është asgjë më shumë se "terror seksual" me themel "trashëgueshëm gjenocidal" dhe përdhunues, pretendon Biljana Plavshiq, muzë e regjimit serb të Bosnjës.

"Përdhunimi, mjerisht, është strategji lufte e myslimanëve dhe kroatëve të caktuar kundër serbëve, islami e konsideron normal, meqë ky religjion lejon poligaminë. Historikisht, gjatë 500 vjetëve të pushtimit turk, ka qenë krejtësisht normale për myslimanët e hierarkisë së lartë të ushtronin të drejtën e përdhunimit të grave të krishtera. Duhet të theksohet se religjioni islamik konsideron se identiteti kombëtar i fëmijës përcaktohet prej babait... Ky terror seksual ushtrohet edhe ndaj burrave dhe merr karakter gjenocidal". ("Borba", 8 shtator, 1993). Është për t'u shquar se kjo serbe e njohur akuzon myslimanët për keqtrajtim të njëjtë që serbët e ushtrojnë në përmasa të gjera ndaj boshnjakëve dhe kroatëve, sidomos përdhunimin masiv si mjet të purifikimit racor!

"Aty ku ka vdekur një serb, atje shtrihet Serbia"

Vetitë e viktimës, njashu sikurse ato të torturuesit, barten nga babai tek i biri: fashizmi është sëmundje ngjitëse, gjenet e tij barten prej një brezi në tjetrin. Është tipar joimun i mishëruar në një popull, dhe historia nuk mund ta modifikojë pavarësisht se çfarë ndodh.

Kjo propagandë ka një aspekt patologjik dhe farsë, që do të ishte temë e mirë për psikoanalizë nëse zgjedha nuk ka gjeneruar drejtpërdrejt terrorizëm. Meqë oscilon ndërmjet arrogancës së pastër dhe mashtrimit moral, retorika serbe nuk është marrë gjithnjë seriozisht, dhe se është për keqardhje meqë gjithnjë e ka thënë se çfarë do të bëjë dhe gjithnjë ka bërë çfarë ka thënë.

Sa më e krisur që dukej në veshët tanë të perëndimorëve, aq më shumë është dashur t'ia vinim veshin. Këto fjalë janë përdorur si

doktrina të shtetit. Ato jo vetëm që kanë hedhur farat e zemërimit në kokat e njerëzve, por edhe e kanë kallur barutin. Këto fjalë ishin armë, këto fjalë kanë vlarë.

Andaj, nuk është se bota i djallëzoi serbët, janë serbët që nisën me djallëzimin e të gjithë fqinjëve të tyre dhe gradualisht krejt botës (hiq disa vende mike, si Greqia, Rusia dhe Rumania) duke shpikur një komplot kundër vetvetes, një komplot të ndërlikuar që përfshin (më fal që lista është shumë e shkurtër) islamin, Vatikanin, Kominternin, "Rajhun e Katërt" të Gjermanisë, masonët e lirë dhe shumë shërbime sekrete perëndimore.

Dhe cilat janë mashtrimet e përhershme paranojake? Shkojnë krah për krah me megalomaninë, duke ia mundësuar ta fryjë vendin e vet të vogël në përmasa planetare. Se serbët dëshiruan të jenë "popull qiellor", që mund të kallë luftëra botërore dhe se qenkan të bindur se janë cak i një aversioni planetar që nxit krejt njerëzimin t'u vërsulen atyre. "Krejt bota është angazhuar për djallëzimin e popullit serb, fenomen i pashembullt në historinë e civilizimeve. Komploti kundër serbëve është mbi të gjitha komplot kundër të vërtetës: ... ndërjegjes së njerëzimit ... si dhe fati i botës është i lidhur me problemin serb". Të prekur prej iluzionit të madhësisë, këta nacionalistë (ku përfshihen edhe burra me nam dhe të shkolluar, profesorë dhe shkencëtarë), shkrihen me mendimin e përhershëm të konspiracionit që ua mundëson të mendojnë se janë alamet të rëndësishëm.

"Nëse krejt bota është në luftë me Serbinë, atëherë një kataklizëm botëror, një vërshim i madh do ta fundosë botën në tërësi, përjashtoj Serbinë e Madhe".

Kjo fantazi e të qenët të rrethuar prej një "konspiracioni islamist-vatikanist-hitlerian", kjo vetëbindje e "urrejtjes së tmerrshme kundër serbëve ... që na bën ne, serbëve të diasporës, të mallkuarit e vërtetë", këto "rituale përbindësheantiserbe" që janë

pjesë e një "simfonie të pabesueshme të djallit" (Kommen Beqiroviq), duke ushqyer kështu një Serbi manikeiste radikale, ka mbetur fikall e vetme kundër krejt universit!

Duke përkulur grupet etnike të cilave synon t'iu shpallë luftë, duke dedramatizuarëkzilin a vdekjen e tyre, përpiqet ta mbulojë zhdukjen e tyre si gabim të parëndësishëm të historisë. Ky pranim duhet të shoqërohet me poshtërim total të tjetrit me qëllim që ta ekzaltojë dhe lartësojë veten në kurriz të tjetrit.

Sa më monstruoz që të jetë krimi i planifikuar, aq më monstruoz duhet të duket e ardhmja e viktimës; krimet e viktimës, në fakt, janë të parashikueshme. Viktima i paralajmëron krimet duke pretenduar se të njëjtat do të kryhen kundër saj.

Dhe bash si e djathta ekstreme që gjithnjë ia atribuonte një fuqi supernjerëzore Internacionales Hebraike - aspiratën për sundimin e botës - edhe ekstremistët serbë ua atribuojnë armiqve të tyre qëllimet më të zeza dhe fantazinë e fuqisë absolute që e bën urgjente shfarosjen e tyre (ndërkaq, në terren, lidhja e forcave gjithnjë ka qenë në favor të serbëve, të cilët janë mjeshtër të artillerisë dhe fuqisë së barutit).

Akuza ngarkuar tjetrit është motori i sulmit që dikush përpiqet ta ndërmarrë vetë. Duke ngritur dyshimin kundër tjetrit për spastrim etnik, thjesht nënkupton pranim dhe përshpejtim të planit që planifikoni ta jetësoni kundër tij.

Andaj krejt çfarë i mbetet të bëjë është të sulmojë të ardhmen e tjetrit me akuza të cilat, në fakt, më vonë do të fajësohet vetë. (Ishte edhe më e dhimbshme të dëgjoje tonin e shpifjes së paraqitur në mediat perëndimore, ta zëmë me barazimet e "kroatit me ustashin", "boshnjakëve me fundamentalistët", për ta parë se kjo propagandë po lulëzonte nën penat e shkrimtarëve që



supozohet se janë të mirinformuar).

Për pasojë, agresioni mund ta veshë veten me uniformën e çiltërsisë: si një komb i engjëjve shfaqëson veten deri në fund të botës prej mundimeve të tij të kaluara, serbët kurrë nuk sulmojnë, vetëm mbrojnë veten. Janë të drejtë, madje edhe kur vrasin; mbrohen prej pafajësisë së papërshkueshme dhe absolute, larg më të lartë se veprat e liga që mund t'i kenë bërë.

Nëse ata vazhdojnë të tregohen mospërfillës ndaj keqardhjes dhe brejtjes së ndërgjegjes, kjo ndodh për shkak se nuk ishin ata të cilët masakruan, ata vetëm se me të drejtë kanë shkelur disa insekte të dëmshme, qelbanikë që vetëm nga pamja duken njerëzorë. Dhe një veteran i Luftës së Dytë Botërore erdhi për ta mirëpritur Zhirinovskyn në Bjelina në Bosnjë në shkurtin e vitit 1994, duke iu drejtuar një gazetari amerikan: "shqiptarët, kroatët dhe myslimanët, dhe kushdo i sojtit të tyre, nuk meritojnë të jetojnë".

"Ky sinqeritet tragjik i vrasësit" (Gaston Bouthoul) e shtyn atë ta dehumanizojë armikun e tij me qëllim që ta eliminojë me ndërgjegje të pastër dhe të mos ndihet asnjë trohë fajtor (me përjashtimin e dukshëm të opozitës demokratike serbe që kërkoi publikisht falje për shkatërrimin e Vukovarit, Sarajevës dhe Dubrovnikut, dhe për rrethimin e enklavave boshnjake).

Ky soj vrasësi e ka mendjen top se po vepron në kuadër të të drejtave të veta me kujtimin e vazhdueshëm të së kaluarës. Andaj në fund të viteve '80, kleri ortodoks dhe njerëzit me pushtet të vërtetë publik i rrahën daullet e luftës dhe shkuan aq larg sa t'i zhvarrosnin edhe eshtrat nga Lufta e Dytë Botërore, me qëllim të fryrjes së flakëve të zjarrit të hakmarrjes.

"Do t'i zhvarrosim eshtrat e martirëve tanë dhe do t'ua dedikojmë një vend të merituar. Eshtrat duhet të prehen më afër parajsës, meqë populli serb gjithnjë ka qenë popull i parajsës dhe popull i vdekjes", shkruante doktor Rashkoviç në fund të viteve '80.

Dhe kjo ushtri e pafund e të vdekurve ishte vërsulur në sulm kundër të gjallëve me qëllim që t'i lante me gjak të gjitha fyerjet e përjetuara. Kjo është propagandë funerale, adhurim i varrezave masive dhe skeleteve, njëfarë nekrofilie pothuajse e maskuar që i jep kuptim të ri sloganit tashmë të njohur: "Aty ku ka vdekur një serb, atje shtrihet Serbia".

Në mesazhin e tij ambicioz gjatë pashkëve në marsin e vitit 1991, u përpoq "ta ringjallte shpirtin e vëllazërisë dhe vëllazërimin në lutje me viktimat tona, të vdekurit e pafajshëm të shenjtë... gjatë pesëdhjetë vjetëve të fundit", citonte patriarku Pavle i Beogradit

"Kryepeshkopin e Madh Nikolajn e kujtimin të lumtur", duke theksuar se "nëse serbët do të merrnin hak për në proporcion me të gjitha krimet që janë kryer ndaj tyre gjatë këtij shekulli, çfarë do të duhej të bënin? Do të duhej të varrosnin burra për së gjalli, t'i hidhnin të gjallët në zjarr, t'i rrjepin për së gjalli, t'i copëtonin fëmijët në sytë e prindërve. Serbët kurrë nuk kanë vepruar kështu, madje as ndaj bishave të egra e lëre më ndaj krijesave njerëzore".

Tani ajo çfarë është mahnitëse në këtë tekst është se përshkruan saktësisht krimet që trupat serbe do t'i kryenin nga qershori 1991 e tutje, me të krisur lufta. Nëse tragjedia, siç thotë Claudeli, është "është kujë e madhe para një varri që nuk është mbyllur mirë", atëherë krejt territori serb, ujitur me sakrificën e martirëve, gulçon për hakmarrje. Rrënjët e këtij nacionalizmi tribal janë larë, folur me të njëjtën gjuhë, në gjakun e të pafajshmëve që vdiqën për atdheun për më shumë se shtatë shekuj. Dhe kjo tokë na qenka e shenjtë, "sepse është një varrezë e madhe e mbushur me ata që vdiqën pa gurë varresh".

Kjo është arsyeja pse ushtarët serbë kanë mësyre frontin qysh prej qershorit 1991, duke marrë krah që të flasin me ata që vdiqën më 1914-18 dhe 1941-1945, të shoqëruar prej krejt atyre që janë martirizuar gjatë shekujve të mëhershëm, me qëllim që ta kryejnë punën e pakryer dhe për ta shndërruar një milenium fyerjesh në orgji të vrasjes shpenguese. Ky procesion pafundësisht i zymtë u shoqërua me lutje të kryepeshkopëve dhe këngë të krijesve të baladave.

Se këta vrasës janë edhe poetë e tregon edhe Karaxhiqi, i cili vetë e ngacmon Muzën në orët e tij idilike; dhe në këtë konflikt, krimi vjen në krahët e poezisë epike, dhe reptilët më të këqij janë të zotë ndërmjet dy masakrave, të thurin një strofë modeste plot me terrinë dhe vrer.

MilanKundera kishte identifikuar një shembull të mirë të kësaj aleance të lirikës dhe krimin nën stalinizëm, sepse "kjo luftë u nxit, u përgatit dhe u ndërmor prej shkrimtarëve dhe u krye prej dorës së shkrimtarëve" (Marko Vesoviç).

Fundja, kjo mësymje mbrojtëse shpjegon natyrën neveritëse të këtij konflikti, në të cilin, së paku në fillim, një ushtri profesionistësh u konfrontua me civilë të paarmatosur, me fushata të prerjes së kokave, torturimit, gjymtimit dhe vrasjes së të burgosurve dhe akteve të panumërta të sadizmit të faktuar hollësisht gjerë e gjatë në raportet e Kombeve të Bashkuara, ky vullnet për ta shfarosur tjetrin, për ta hequr nga faqja e dheut edhe kujtimin e ekzistencës së tij.

Sa për informacion, duhet të dihet se lideri i serbëve të Bosnjës,



RadovanKaraxhiq, ish-psikiatër, po punonte para luftës me pacientët e tij në Sarajevë mbi fantazinë e prerjes së trupit në dy pjesë - gjë që beson se është e pranishme te krejt burrat.

Në versionin e tij benin, viktimizimi është formë paradoksale e snobizmit. Në versionin e tij të krisur, është mohim aktiv i konceptit të njerëzimit, thirrje e hapur për vrasje.

Vrasësit engjëllorë

Retorikën e Serbisë së Madhe duhet marrë gjithnjë ndryshe, duke interpretuar secilën fjali në kuptim të kundërt të manifestit; duhet të mësohemi me idenë se dhuna flet me gjuhën e paqes, dhe fanatizmi me zërin e arsyes; duhet të mësohemi se hedhja poshtë e gjenocidit po përdoret si motor i një krimi të ri kundër njerëzimit. Kurrë nuk e përthekon më mirë sjelljen e Serbisë së Madhe sesa fjalia që GeorgeSteineri ia atribuon Hitlerit në njërin prej librave të tij: "Do t'i zbatoni metodat e mia derisa njëherësh do të më refuzoni".

Kështu, nëpërmjet një mashtrimi të madh, ata që duhet të ulen në bankën e të akuzuarve janë ulur në bankat e prokurorëve; andaj, nacionalizmi serb, që shquhet për maskimin e tmerreve nën gunën fisnike të luftës kundër fashizmit, kulmon në revizionimin më të neveritshëm.

Në Beograd lufta në Bosnjë është quajtur "lëvizje çlirimtare antigjenocid", dhe në kampet serbe të mbajtjes (dhe shfarosjes), pengjet boshnjake dhe kroate u gjykuan për "krime të gjenocidit kundër popullit serb", kur dihet mirëfilli se krimi i tyre i vetëm ishte pse u lindën kroatë ose boshnjakë; në Beograd gjatë vitit 1992 u botua një libër me titullin "Sarajeva, kamp përqendrimi për serbët".

Nga mesi i gushtit 1993, kur Sarajeva kishte më shumë se një vit nën rrethim dhe 70 për qind e territorit të Bosnjës ishte nën

kontrollin serb, Republika Federale e Jugosllavisë (Serbia dhe Mali i Zi) i kërkoi Gjykatës së Hagës që t'i kërkonte Qeverisë zyrtare të Sarajevës t'u jepte fund "akteve të gjenocidit kundër grupit etnik serb". Operatorët serbë të turizmit organizuan udhëtime për Vukovar për të verifikuar "në vend" gjenocidin e kryer prej forcave "ustashe".

Së fundi, në kulmin e mjerimit, në janarin e vitit 1992, në Qendrën Kulturore në Paris (dhe njëherësh në Beograd) planifikohej një ekspozitë me titullin: "Vukovari 1991, gjenocidindaj trashëgimisë kulturore serbe" (ekspozita shkaktoi zemërim të madh, dhe kurrë nuk u hap edhe në Francë).

Ndërkaq qyteti austro-hungarez plot shkëlqim i Vukovarit ishte rrafshuar prej ushtrisë serbe më 1991, dhe popullsia e saj ishte likuiduar ose shporrur, ndërkaq agresorët pretendonin pa fije turpi se ishin mbrojtësit e tij dhe se banorët e tij ishin ata që shkatërruan gjithçka rrafsh me tokë.

Ne e dimë mirë se kjo propagandë ka çorientuar kuptimin e fjalës "gjenocid". Sidoqoftë, gjithashtu është pasuruar me dhënien e kuptimit të ri: prej tash e tutje çdo popull që masakron ose shkatërron një tjetër mund të krenohet me veten se vuajti prej gjenocidit.

Për shumicën e krimeve të tmerrshme të kryera prej trupave serbe janë fajësuar viktimat e tyre: ka diçka si puna e Krishtit në këtë far mashtrimi për shpirtat, në këtë diversion të martirëve - por është një Krisht i paturpshëm, në fakt një Antikrisht - ai që vret dhe pastaj dëshiron që pikërisht atij t'i shprehin keqardhje.

Kjo është një sqimë supreme e vetë Djallit: fajësoje viktimën për djallin që i është lëshuar atij në qafë. Prej këtij këndvështrimi, gjermanët do të justifikoheshin në pretendimin se ishin cak i një gjenocidi në Auschwitz në emër të hebrenjve dhe romëve, turqit do të mund t'i akuzonin armenët për masakrimin e tyre më 1915, ekstremistët hutu do të mund t'i akuzonin tucit, e kështu me

radhë.

Kjo është përmbetje tronditëse e së vërtetës: vrasësi është viktimë e viktimës së tij, dhe nëse unë të vras, fajin e ke ti - në fakt jeni ju që më vrisni. (Një tjetër alternativë e kësaj sjelljeje: ndëshkoji viktimat dashakeqe që të detyrojnë t'i bësh martire). Është mashtrim i dyfishtë; shtypësi përvetëson dramën e të shtypurit dhe, njëherësh, shlyen të gjitha gjurmët e krimin të vet.

Andaj, mund të kënaqeni me shqetësimin që rrethon humbësin, përderisa i gëzoni të gjitha përfitimet prej të qenët fitues. (Në raste të caktuara, vampirizmi e arrin kulmin. Sipas Shoqatës së Popujve të Kërcënuar, shumë kriminelë serbë të luftës fshihen jashtë vendit pasi kanë marrë identitetin e atyre që i kanë shfarosur). Një engjëll sipëror i mbuluar me gjak, torturuesi pastaj mund ta qajë veten me ndërgjegje të pastër, madje edhe para një grumbulli kufomash.

Natyrisht, konflikti në ish-Jugosllavi nuk zhvillohet vetëm ndërmjet regjimit të Beogradit dhe fqinjëve të tij; ai poshtëron Serbinë e hapur, liberale, pluraliste kundër një tjetër Serbie, kryesisht rurale, që është e prapambetur dhe shumë krenare me primitivizmin e saj barbar, që vjell prej përzierjes etnike, papastërtisë në Beograd dhe përgjithësisht, në shumicën e qyteteve, folur me fjalët e një ekstremisti, prej "atyre stallave derrash, ku janë lindur ata bastardë prej martesave ndëretnike". (Kjo shkon saktësisht paralelisht me mënyrën se si nacionalistët kroatë të Hercegovinës i binin vetes në qafë kundër Mostarit, simbolit të sinkretizmit turko-sllav, ku ata kompletuan shkatërrimin pas bombardimeve serbe).

Dhe "miqtë" e Serbisë, në Francë, do të frymëzoheshin fort sa ta përkrahnin fraksionin më të përndritur të popullit serb, ata që aspironin paqen dhe një Evropë të bashkuar, në vend se të mbështesnin një diktaturë gjëmëmadhe që vendit i solli marre, histeri dhe aventurë

ushtarake që, mbase, do ta ngufatë krejt rajonin në flakë.

Fundja, drama e ish-Jugosllavisë vjen për shkak se me Evropën të pazonjë ta zbatonte ligjin, ligji i vrasësve u shndërrua në ligj për krejt fraksionet etnike, dhe purifikimi u shndërrua në emërues të përbashkët ndërmjet tri kampeve. Çka është e pahijshme kur flitet për luftën është bashkëfajësia e pashmangshme që valëvitetndërmjet armiqve të cilët mendojnë se nuk kanë asgjë të përbashkët, por që përfundojnë në përngjarje të njëri-tjetrit përherë e më shumë.

Pa një traditë demokratike, pa një lider i cili do të mund të matej me mendjen djallëzore të Millosheviqit, mjerisht të armatosur dhe të krisur prej shkuljeve ndaj lidhjeve të ngushta dhe me privilegjin e madh që e gëzonte agresorin, dhe specifikisht të braktisur prej njerëzve të cilëve iu përgjyruan për ndihmë (evropianëve dhe amerikanëve), kroatët dhe boshnjakët, secili në nivel tjetër (dhe pa mbërritur asnjëherë në përmasat e nivelit të egërsisë së trupave nga Pale dhe Beogradi), iu kthyen së pari serbëve, dhe pastaj njëri-tjetrit (gjatë luftës që u zhvillua deri në shkurtin e vitit 1994). Ishte hata që e kishin përjetuar prej agresorit të tyre të përbashkët.

Mendja gjeniale e përdrejtë e Millosheviqit ia mundësoi që t'i përcante armiqët, duke i injektuar me helmin e urrejtjes etnike, që do ta shndërronte në njëfarë justifikimi a posteriori: "I shihni sa përbuzës (ose fanatikë) janë? Sa shumë patëm të drejtë që u ndamë prej tyre".

Një imitum tronditës i rolit të viktimës: modeli i pushtuesit ka kontaminuar (pjesërisht) atë të të nënshtruarit, dhe konfrontimi i përgjithshëm justifikon shkakun e supozuar të ndezjes së luftës - idenë se ishte e pamundshme që dy bashkësitë të jetonin bashkërisht.

Dhe është thjesht e mrekullueshme që në Sarajevë dhe enklavat e tjera të Bosnjës (dhe në Kroaci, ku jetojnë qindra mijëra refugjatë boshnjakë), serbët, kroatët dhe myslimanët ia dolën mbanë të bashkëjetonin kaq gjatë, ia dolën ta ruanin dinjitetin dhe tolerancën e tyre pavarësisht prej bombave, sanksioneve dhe urisë. Në këtë drejtim, pavarësisht prej çmendurisë që duket se ishte propaganduar te të gjitha palët, fajësia e regjimit të Millosheviqit shkon përtej çdo dyshimi (megjithëse regjimi tani, nëpërmjet oportunitetit politik, predikon paqe apostolike, një AlCapone i maskuar si Mahatma Gandhi).

Sidoqoftë, gjithçka shkoi në fund të pusit në luftë ose diplomaci. Serbët përfundimisht e humbën kurorën e pruar të martirizimit, të cilën ua kishte

rrënjësuar historia e kaluar. Dhe ja si e vrojtonte këtë lideri opozitar serb, Vuk Drashkoviç: "Në këto krime të tmerrshme të luftës, që ende po vazhdon, dhe fundi i së cilës zor se mund të parashikohet, dallimi ndërmjet librit të turpit dhe librit të dritës, është shlyer deri në pikë të fundit. Dhe kjo është disfata më e madhe serbe, disfata e vetme e popullit tonë në historinë e ekzistencës së tij". Dhe Serbia e Millosheviqit ka jetësuar atë që e ka përmbledhur më së miri Marek Edelman: "Fitoren posthumus të Hitlerit".

Gjatë gjithë konfliktit, në secilin rast, nuk është ndërmarrë asgjë (prej bashkësisë ndërkombëtare) për ata nën sulm, shkeljet e vetme të të cilëve ishin analizuar në mënyrë maniake, përderisa sulmuesit shkriheshin me duart e lira qysh prej ditës së parë. Krimi i vetëm i boshnjakëve (dhe kroatëve para tyre) në sytë e qeverive perëndimore ishte rezistenca në vend se të dorëzoheshin vetë në kasaphane, duke ua prishur hesapet kryeqyteteve të mëdha që kishin llogaritur fitore të shpejtë të Serbisë, fuqia e vetme që do të mund të mbante rendin në Ballkan pas dezintegritetit të Jugosllavisë.

Për t'i ndëshkuar ata që ishin sulmuar (të cilët ishin edhe separatistë), përdorëm dhe shpërdorëm sofizmin fatal që sugjeron se çdo viktimit është një zuzar i ardhshëm potencial, dhe refuzuam t'i ndihmonim, sepse mund të bëheshin njerëz të ligë. Çka tjetër mund të përbëjë mashtrim më të madh për drejtësinë?

A po fundoset një fëmijë para syve tuaj? Punë e madhe, le të fundoset, ose ndryshe, më vonë do të shndërrohet në përbindësh. Pse viktimat duhet të jenë të pacene dhe pa të këqija? A paskemi harruar ne se rezistenca franceze dhe e aleatëve kishte kryer ndonjëherë krime të tmerrshme? As boshnjakët e as kroatët nuk janë sjellë si engjëj, por askush nuk do ta ndihmonte kurrë dikë nëse do të ngulmonim se pala e dëmtuar duhet të jetë e butë si qengji. Ne nuk e kushtëzojmë ndihmën tonë për njerëzit në rrezik varësisht se a e "meritojnë".

Ndëshkimi i krimit si kusht për pajtim

Modeli i fryrjes flakëve të zjarrit të madh është zhvilluar aty ku ne shmangim përfshirjen, së paku kur interesat tona preken drejtpërdrejt. Krejt së fundi, ngrysja më e vogël nga SaddamHuseini do të mjaftonte që të mobilizohej krejt flota detare luftarake, e kurrkush nuk do të lodhej për natyrën demokratike të Kuvajtit; ngjashëm u pritën me masa gjysmake krimet serbe dhe gjenocidi i tutsive në Ruandë.

Në këtë terr të madh të paqartësisë, kur të gjithë luftëtarët janë grirë, ne shmangim pranimin me qëllim që të mund t'i

bishtnojmë përfshirjes. Ky triumf i parimit të ekuivalencës - ata krejt janë njësoj - nuk është kurrëgjë tjetër pos negacionizëm. Vetëm merreni me mend nëse ne do të duhej ta riinterpretuam Luftën e Dytë Botërore sipas të njëjtave parime: në atë rast, më nuk do të ishte e mundshme të shquhej e mira prej djallit, dhe Shoah do të ishte vetëm palë plotësuese për kërcënimin sovjetik (si në tezën e preferuar prej shkollës revizioniste gjermane).

"Refuzimi i manikeizmit", me të cilin krenohen disa njerëz si të ishte eksploatim intelektual, refuzimi për t'u futur ndërmjet, fshihet si keqardhje aktive për agresorin. Mosmbajtja anë në një konfrontim ndërmjet të fortit dhe të ligshmit, është e barabartë me animin nga pala më e fortë dhe inkurajim për sipërmarrjet e tij.

Neutraliteti është edhe një emër tjetër për bashkëfajësinë. Dhe mos pyet për viktimat, të cilëve u është plaçkitur edhe respekti për vuajtjen e tyre - duke i ngatërruar me torturuesit e tyre; dhe mos pyet për viktimat e Prijedorit, Omarkës, Sarajevës, Vukovarit dhe Gorazhdës, të vrarë dhe të gjymtuar për herë të dytë prej indiferencës sonë. Në siklet që ua kemi kthyer shpinën, ne ua konfiskojmë edhe vuajtjen, i privojmë prej së drejtës për të mbetur në kujtesën e të gjallëve!

Tri krime të mëdha kanë ndodhur që nga viti 1941 në sferën mendore të sllavëve të jugut: ai i ustashevë - më i tmerrshmi prej të gjithëve, derisa nuk provohet ndryshe; ai i çetnikëve - për të cilin dihet shumë pak; dhe, në fund, ai i Titos dhe komunistëve - prej çlirimit deri në vdekjen e diktatorit të kuq.

Asnjëra prej këtyre tri krimeve, për shkak të së vërtetës zyrtare të imponuar prej bolshevizmit, nuk ishte gjykuar ose vënë në vendin e duhur, e as nuk është analizuar dhe shpjeguar me korrektësi (hiq pretendimet propagandistike) deri në shpërthimin e luftës në qershorin e vitit 1991. Akumulimi i këtyre tri ngjarjeve të dhimbshme shpjegon ligësinë e ashpër në Ballkan dhe faktin se çdo bashkësi tundet ndërmjet amnezisë dhe vullnetit për hakmarrje.

Urrejtja dhe zemërimi u flakëruan përsëri kundrejt kundërmimit të të varrezave masive, dhe miqësia ndërmjet popujve nuk u rezistoi valëve të gjakut që datojnë prej kohësh. Kjo është arsyeja pse është imperativ të ndëshkohet krimi i katërt, ai i Millosheviqit - për t'i gjykuar vrasësit nga secila palë; ky është kusht i pashmangshëm i çdo pajtimi ndërmjet popujve dhe heqje dorë prej retorikës hakmarrëse që akuzon kolektivishtkëdo, meqë është e vështirë të identifikohen ata që përnjëmend janë përgjegjës.

A mund të ndodhë që

shembulli jugosllav, së paku, po na i hap sytë: vërjani mendjen një populli që aspiroon shenjtërimin për shkak të vuajtjeve të veta, që fillon t'i shpalsë plagët e veta dhe llogarit të vdekurit e vet. Po planifikon një punë të ndyrë, në vend se të parandalojë rikthim të vrasjeve masive, po i kujton vetëm sa për t'i kryer edhe një herë. Duke u veshur me gunën e shenjtërimin, vrasësit, para se t'i mprihin thikat e tyre, po kërkojnë leje prej botës së civilizuar - derisa presin, mbase, që një ditë, t'i kthejnë thikat edhe kundër asaj.

Princesha Bibesco e kishte shprehur të thoshte se "rënia e Kostandinopojës është fatkeqësi që më ndodhi javën e kaluar" dhe kultivonte "mundësinë e vajtjes dhe ardhjes, të rrotullimit të orës së rërës, të ndërrimit të fatit të kohës sonë, të jetës në trupat e të tjerëve..."

Ka në të vërtetë popuj të caktuar dhe krijesa të caktuara që ruajnë njëfarë intimiteti joshpirtëror me të kaluarën e tyre që mbetet përherë e pranishme; krijesat dhe popujt që shprehin zotësi të paharrueshme që të jenë bashkëkohës me shekujt e kaluar, aventurat e të cilëve ata pa u lodhur i ringjallin si shumë episode të jetës së tyre të përditshme. Dhe nuk ka kapërcim ose nostalgji kur shtetet e Evropës Lindore dhe Qendrore përpiqen ta ripërvetësojnë historinë e tyre, për t'i lidhur ngushtë bijtë e lidhjes së këputur prej dekadave të propagandës dhe rrenave komuniste. Rikthimi i kujtesës së dikujt është faza e parë e lirisë; pranimi është, mbi të gjitha, pranimi i traditave të tjetrit, edhe në qoftë se vetëm sa për të qenë në gjendje t'i ndash ata prej vetes ose t'i shtrosh në kontekst të ri.

Kujtesa mund të përdoret, gjithashtu, jo vetëm për promovimin e përbashkimit, por edhe për traumatizim, për të festuar të zezat që i kanë rënë në qafë një populli dhe për të cilat populli nuk mund të vajtojë meqë ato nuk po i ndahen, nuk po përkohet këndshëm me hambarin e historisë; ato vazhdojnë të lëndojnë edhe pas shumë vjetësh.

Pastaj kujtesa shndërrohet në paralajmërim, vigjilencë ndihmëse. "Kujto", thuhet në muzetë e mëdha të gjenocidit (YadVashem në Jerusalem, TuolSlang në PhnomPenh). Kurrë mos e harro atë çfarë është bërë në emër të racës ose të revolucionit prej regjimit nazist, diktaturës së Pol Potit.

Këta miliona burra, gra dhe fëmijë, të cilët u vranë për ta shlyer krimin e vetëm pse ishin lindur, duhet të na kujtojnë neve se ndodhi një terror ndaj të cilit kurrkush nuk mund të rrijë duarkryq. Kjo është arsyeja pse Holokausti, për nga natyra e vet unike, u bë gjenocid reference, krim absolut krahasuar me ato që i gjykojmë si krime të ngjashme.

Jo se vrazhdësia ishte rezervuar për një popull specifik, por djalli i

vërtetë ndërron njëqind fytyra dhe përbuz krejt njerëzimin, duke përdorur si shembull një hebraik ose rom. Një krim kundër "njerëzores së njeriut në përgjithësi" (V. Jankélévitch); krim kundër faktit se njerëzit ekzistojnë. Por kujtesa në këmbim të saj in mund të shtrembërohet në dy mënyra: me fyerje dhe papajtueshmëri.

Kur është larg prej ringjalljes së martirizimit, ua nënshtron veten diktateve të nacionalizmit agresiv dhe shndërrohet në katalog ngjarjesh shpagueuse, kur e kufizon veten me obsesion ndaj ringjalljes së vuajtjeve, për t'i rihapur plagët me qëllim që të fitojë më shumë legjitimitet për vullnet ndëshkimi.

Pastaj shndërrohet në dorë të zgatur të zemërimit, të përcmimit: merr karakter të krisur, rikonstruktin të kaluarën si ai që i ndërron fytyrat degjeneron në mit, në fabul, kujtesë mercenare që më pak shqetësohet për kujtimin e të vdekurve sesa për lansimin e reprezaljeve kundër të gjallëve. Do të gërmojë thellë në konflikte të pazbardhura që datojnë prej kohës antike, do t'i përflakë tensionet dhe ekzagjerojë hasmëritë sikur e gjithë historia të ishte vetëm një fitil që digjet ngadalë që e ka të shkruar të eksplojojë sot.

Kjo është arsyeja pse ka diçka jashtëzakonisht të rëndësishme në shprehjen e Ernest Renanit: "Kushdo që dëshiron të bëjë histori, duhet ta harrojë historinë". Nëse të gjithë njerëzit që ishin lënduar do të vazhdonin t'u ktheheshin ankesave të tyre respektive, nuk do të kishte as paqe e as harmoni mbi faqe të dheut.

Çdo shtet, rajon, madje edhe fshat do të mund të përmendte njëfarë të keqeje që i ishte bërë brenda 500 a 1000 vjetësh të kaluar dhe për çdo sëpatë të varrosur, çdo familje do të bëhej pikë e pesë për të njëjtat arsye, pa qenë të zotë të kapërceheshin të gjitha mosmarrëveshjet e përbashkëta. Kur keqbërësi të gjykohej dhe ndëshkohej, dhe do të kompensoheshin dëmet, dhe do të bëhej falja me pajim të viktimave nëse do ta gjykonin të domosdoshmen, atëherë vjen momenti kur, me kohën që e ka bërë të veten, ne duhet të tërheqim një vijë, t'i lëmë të vdekurit t'i qajnë të vdekurit, dhe ta lëmë urrejtjen dhe belatë e tyre të varrosen me ta.

Nëse dëshirojmë të jetojmë në paqe me bashkëkohësit, nuk mund të gërmojmë krejt pikat e hidhura të historisë sonë. Harrimi është një prej gjërave që krijon hapësirë për të gjallët, për të porsaardhurit të cilët nuk dëshirojnë të bartin mbi shpatulla peshën e hasmërive të vjetra. Sikurse e thotë edhe HannahArendt, harrimi ua mundëson brezave të ardhshëm aftësinë për të nisur përsëri gjithçka nga e para.

Ka edhe një tjetër anë të kujtesës sfiduese që paradoksalisht i mëshon fort vrazhdësisë së re. Në kohën tonë, në të vërtetë, komemoracionet e përsëritura të masakrave të së djeshmes janë të ngërthyer me konfuzionin dhe mospërfilljen kundrejt masakrave të së sotmes. Sa më shumë që merremi me viktimat e torturës të së djeshmes, aq më pak kujdesemi për ato të së sotmes.

Ka një mënyrë të "shenjtërimit të Holokaustit" (Arno J. Mayer), të shndërrimit të tij në një ngjarje që është e lidhur aq ngushtësisht me veten sa që ne nuk kemi fare konsideratë për viktimat e fatkeqësive të tjera. Ne mbërthehem i aq fort pas të vdekurve të Auschwitzit me sekretet e tyre tmerruese dhe nuk bëjmë hesap askënd tjetër.

Gardianë të së padurueshmes, asnjë ngjarje e sotme nuk na kënaq, asgjë nuk mund t'u afrohet përmasave të tmerrit që e kultivojmë për bukur: luftërat e sotme, masakrat bashkëkohore, i shtyjme anash me shuplakën e dorës. Kotësi na duken krahasuar me dramën e madhe, agjentë të së cilës jemi.

Një qasje e tillë, në vend se ta ngrejë aversionin tonë ndaj padrejtësisë, na kurthon në krahasim: cili duhet të jetë drejtimi që qartësia të shndërrohet në shkëputje? Andaj ekziston rreziku se komemoracioni ekskluziv i Auschwitzit do të përbente ndërhyrje të padenjë në hatatë e tashme.

Çfarë të mire kanë fjalët tona magjike antitotalitare, nëse do të përipiqeshim ta zhvendosnim Hitlerin ose Stalinin retrospektivisht, në vend se të përballëshim me despotët e sotëm dhe sharlatanët gjakpirës, që sjellin shkatërrime në nivelet e tyre? A duhet të presim derisa kasaphana t'i mbërrijë dimensionet e Shoah para se ne të veprojmë?

Guximi i vërtetë nuk do të thotë të bëhesh hero që mbron faktin dhe denoncon nazizmin më 1995, por ta luftosh çnderimin pikërisht në kohën tonë. Më shumë është punë e hapjes së komemoracionit të Auschwitzit për të gjithë ata që u masakruan dhe u torturuan, me dobinë e mosshkrirjes së një krimi me një tjetër, por që ta pranohet se ekzistojnë manifestime të ndryshme të gjenocidit, që të gjitha janë krime, por që nuk sfidojnë karakterin e rrallë të Shoah, "asaj kryevepre të urrejtjes" (Vladimir Jankelevitch).

Me fjalë të tjera, dy gabime duhet të shmangen: 1) ideja se gjithçka është e barabartë, tendenca për ta lartësuar krimin më të vogël në majën e një shfarosjeje masive, pa e kuptuar se ka shkallë poshtërimi, se jo të gjithë vrasësit janë të njëjtë; dhe 2) diskreditimi i çfarëdo krimi tjetër për arsye se nuk është Holokaust dhe se nuk mund të krahasohet me standardin e artë të terrorit.

Nuk është zgjidhje ndërmjet kujtesës që mban gjallë antagonizmat shekullarë dhe të shkarjes së kujtesës, që shlyen tragjedi dhe fal torturuesit. Kujtesa e vetme e domosdoshme është ajo

që mban gjallë thelbin e ligjit: është pedagogji e demokracisë, inteligjencë e indinjatës. Urdhri që u jepet atyre që janë lindur pas Shoah dhe Gulagut nuk është edhe aq i lidhur me peshën e kujtesës, por më fort që të sigurohet se këto krime, edhe në formën më të butë të mundshme, të mos përsëriten kurrë. Ky është borxhi ynë i madh që u kemi martirëve të shekullit; që ta parandalojmë përsëritjen e urrejtjes, pavarësisht se në çfarë dimension, forme ose fytyre që mund të ketë. Por, për ta arritur këtë, nuk mjafton vetëm kujtesa; kujtesa nuk është siguri. Që burrat në një çast të caktuar në historinë e tyre t'i rezistojnë vrazhdësisë duhet edhe njëfarë elementi i pamatshëm, një kthesë e madhe, një mrekulli që do t'i shpëtonte prej çnderimit dhe do t'i shtynte ata të thonë "jo", që t'ia mbajnë anën të pambështeturit. Është kjo kthesë e madhe, vendim ky që absolutisht inauguron lirinë, me të cilën do të gjykohej një brez.

Komplete me shumicë

Duke mbrojtur ligjin e vitit 1993 që i detyron qytetarët grekë ta theksojnë religjionin e tyre në letërnjoftime, zëdhënësi i Sinodit të Shenjtë akuzon "lobin hebraik amerikan" se po përipiqet ta shkatërrojë unitetin kombëtar helen me kontestimin e këtij ligji (i cili është më shumë se i mirëseardhur për Kishën Ortodokse).

Kur filmi i tij *Do the Right Thing* për pak s'e fitoi Palmën e Artë në Cannes më 1990, regjisorin afro-amerikan, Spike Lee, fajin e dështimit ia la racizmit të bardhë. Kreu i komisionit juridik dhe politik i GIA-s (Grupi i Armatosur Islamik), një prej lëvizjeve kryesore terroriste në Algjeri, Saif Allah Jaafar, shpjegon: "Ne i sulmojmë hebrejtë, të krishterët, të pafetë, sepse ata janë ihtarë të komplotit kolonialist jofetar. Ata janë simbole të gjalla të pushtimit të Algjerisë, si dhe të vendeve të tjera islamike; në tokën e islamit, këta të huaj janë vetëm spiunë të pafe".

Zviad Gamsakhurdia, presidenti i fundit i Gjeorgjisë, për rrëzimin e tij nga pushteti fajësoi një komplot transnacional që kontrollohej diku në Uashington, që po përipiqej ta shrinte dorën sunduese anëmbanë botës: "Skenari i grushtshtetit të përhershëm në Gjeorgji tashmë është provuar më shumë se një herë në pjesët e tjera të botës... Krejt kjo na ndodhi për shkak se nuk deshëm të ishim subjekt i diktatit të shteteve perëndimore... dhe të bëheshim koloni. Vetëm një pushtet servil është i përshtatshëm për Perëndimin. Kjo është një prej arsyeve për grushtshtetin ushtarak që solli në pushtet figurën e Shevardnadzes, i cili është agjent i CIA-s, agjent i drejtpërdrejtë i imperializmit euro-amerikan".

Leonard Jeffries, drejtor i Departamentit të Studimeve të

AUSCHWITZ 1940-1945



KOSOVO 1998-1999



Çështjeve të Lidhura me qytetarët afroamerikanë në Kolegjin e Qytetit të Universitetit Shtetëror të Nju-Jorkut, shpjegon skllavërinë prej së cilës vuajti populli i tij, me këto fjalë në majin e vitit 1991: "Hebrejtë janë krerët kryesorë të tregtisë me skllavë, dhe ishin ata financuesit e saj. Ata janë krerët e një konspiracioni të planifikuar dhe të organizuar nga Hollivudi me qëllim të shkatërrimit të zezakëve".

Më 2 gusht 1994, në kohën kur liria italiane kishte marrë teposhtën e madhe, ministri për Punë, Clemente Mastella, anëtar i Aleancës Kombëtare (të së djathtës ekstreme, fajësoi "lobin hebraik ndërkombëtar", në të cilin dyshon se mund t'i duan neofashistët e rinj italianë. Prapë, gjatë verës së vitit 1994, revista e përdyjavshme islamike egjiptiane, *ElChaab*, denonconte Konferencën e OKB-së për Zhvillimin e Popullsinë, që do t'ua bënte qejfin në shtator përpjekjeve amerikane dhe evropiane për imponimin e "libertinizmit dhe abortit" dhe për "t'i shfarosur popujt e shtypur, përfshirë

myslimanët, por ka nxitur gjakderdhje".

Ivan Czurka, lider i së djathtës populiste dhe nacionalist i regjuri, thekson ekzistimin e një komploti kozmopolitan "kundërekonomisë hungareze", si arsye pse mbështetësit ndërkombëtarë vazhdojnë t'u japin hise ish-komunistëve, të cilët ende kontrollojnë një pjesë të aparatit të shtetit. Është çartur pse hebrejtë kanë zënë disa prej pozitave të rëndësishme në nomenklaturën e vjetër.

Për Alexander Zinovievin, ish-disident që favorizon restaurimin e komunizmit në Rusi, Perëndimi ishte aty për ta shkaktuar rënien e vendit të tij, duke paguar Yeltsinin dhe Gorbachevin për shkatërrimin e sovjetizmit dhe për ta shtypur Rusinë e Shenjtë. "Ata përfaqësojnë kolonën e pestë të Perëndimit, që i bleu ideologjikisht për t'i hequr qafe njëherë e përgjithmonë dhe bashkë me Rusinë".

Tema e komplotit është garanci për shpjegimin e të gjitha ngjarjeve si jetësim i veprimit të forcave të mistershme. Por emërtimi i Satanit të Madh mund të

funksionojë në dy mënyra: ose është formë e dorëzimit (çka ia vlen të luftohet kur një inteligjencë më e lartë po i komandon qëllimet skëterrë kundër nesh?), ose identifikon një kurban, një armik i cili duhet të shkatërrohet për ta rikthyer harmoninë e humbur (qysh vepron sot Serbia ose Algjeria). Nocioni i një konspiracioni është i pakundërshtueshëm, meqë çdo argument kundër tij mund të përdoret si provë e pushtetit depërtues të korrupsionit të konspiratorëve. (Dhe, si thotë paranojaku, "është faji im pse gjithnjë kam të drejtë?"). Ideja e konspiracionit injekton ata të cilët mendojnë se janë cak i tij kundër dhimbjes nga kritikata, nga kontestimi. Dhe pastaj, u ofron atyre ngushëllim suprem: i bën të ndihen se janë mjaftueshëm të rëndësishëm për dikë, diku mbi faqe të dheut, sa të përipiqet t'i shkatërrojë. Dhe konspiracioni më i keq është ai i indiferencës: Sa prej nesh do ta shpëtonim idenë se ne nuk japim mjaftueshëm dashuri ose urrejtje për të justifikuar të ligën më të vogël prej dikujt tjetër?

Përktheu: Rexhep Maloku

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Sonte Zvicër - Spanjë dhe Belgjikë - Itali

Çerekfinalet e Evropianit fillojnë sonte (e premte) me dy ndeshje të "zjarrta". Zvicra, pas befasisë që e shkaktoi në përballje me Francën, tash synon ta bëjë të njëjtën gjë edhe ndaj Spanjës nga ora 18:00, derisa finalja e parakohshme Belgjikë - Itali zhvillohet nga ora 21:00

UEFA EURO 2020

Saint Petersburg Stadium - St Petersburg
Quarter-finals
SWITZERLAND **Fri 2 Jul** SPAIN
18:00

Football Arena Munich - Munich
Quarter-finals
BELGIUM **Fri 2 Jul** ITALY
21:00

"Epoka e re"

SAINT PETERSBURG, 1 KORRIK - Zvicra e motivuar pasi eliminoi Francën nga Kampionati Evropian "Euro 2020" do të provojë ta eliminojë edhe Spanjën dhe të kualifikohet në mesin e katër kombëtareve me të mira. Zvicra e tre shqiptarëve, Granit Xhaka, Xherdan Shaqiri dhe Admir Mehmedi, përballet sonte (e premte) me Spanjën në Saint Petersburg nga ora 18:00. Zvicranët e eliminuan

Francën pas ekzekutimit të penaltive (5-4) derisa Spanja në çerekfinale u kualifikua pas e mposhti Kroacinë në kohën shtesë (5-3). Lajm i keq për Zvicrën është mungesa e kapitenit Granit Xhaka i cili nuk mund të paraqitet në këtë ndeshje për shkak të kartonëve. Trajneri Vladimir Petkoviç ka kërkuar nga futbollistët zvicranë që të jenë gati për ndeshjen ndaj Spanjës, njëjtë sikurse që ishin kundër Francës. "Ndeshja ndaj Francës ishte shumë emocionale për ne. Lojtarët dhanë 120 % nga

vetja. Ishte, ndoshta, ndeshja më e mirë e skuadrës time ndonjëherë. Neve do të na duhet një paraqitje e njëjtë ndaj Spanjës në çerekfinale", ka thënë Petkoviç. Nga ora 21:00 do të zhvillohet edhe ndeshja e dytë çerekfinale në mes të Belgjikës dhe Italisë dhe kjo vlerësohet si një finale e parakohshme në "Euro 2020". Belgët janë në krye të renditjes botërore dhe ende nuk kanë pësuar humbje këtë vit, derisa italianët janë në formë të jashtëzakonshme dhe pa humbje në 31 ndeshje. Belgjika

mund të luajë në këtë ndeshje pa dy lojtarët shumë të rëndësishëm Kevin De Bruyne dhe kapitenin Eden Hazard, të cilët në ndeshjen ndaj Portugalisë është dashur të zëvendësohen. Trajneri Roberto Martinez konfirmoi se asnjëri nuk ka pësuar lëndim serioz, por të dy këta futbollistë nuk janë plotësisht të aftë për ndeshjen çerekfinale të së premtes. Në anën tjetër, Italia pritet të jetë e kompletuar, pasi janë rikthyer kapiteni Giorgio Chiellini dhe Alessandro Florenzi.

Formacionet e mundshme:

Zvicra: Sommer; Elvedi, Akanji, Rodriguez; Widmer, Freuler, Zakaria, Zuber; Shaqiri; Embolo, Seferović.
Spanja: Simon; Azpilicueta, Garcia, Laporte, Alba; Koke, Busquets, Pedri; Sarabia, Morata, F.Torres.
Belgjika: Courtois; Alderweireld, Vermaelen, Vertonghen; T. Hazard, Witsel, Tielemans, Meunier; Mertens, Lukaku, Carrasco.
Italia: Donnarumma; Di Lorenzo, Bonucci, Chiellini, Spinazzola; Barella, Jorginho, Verratti; Chiesa, Immobile, Insigne.

Fetahu: Nuk ka krenari më të madhe se të luash për Kosovën

PRISHTINË, 1 KORRIK - Përfaqësuesja A në konkurrencën e femrave është duke vazhduar përgatitjet intensive para debutimit në arenën ndërkombëtare. Kjo është hera e parë që Kosova A te femrat do të garojë në Kampionatin Evropian për Shtete të Vogla. Kryetari i Federatës së Basketbollit i Kosovës (FBK), Arben Fetahu, ka motivuar vashat e Kosovës para debutimit. "Për veten time nuk kam pasur kurrë emocion më të madh sesa kur kam veshur bluzën e Kosovës dhe është intonuar himni i Kosovës në një ngjarje në Estoni. Për ju që nuk keni luajtur më herët për Kosovën, do të jetë përvojë



shumë emocionuese, por nuk ka krenari më të madhe se të luash për Kosovën. Kam ardhur

t'ju them se Federatën e keni prapa. Do të mundohemi t'ju përkrahim aq sa mundemi", ka

thënë Fetahu para lojtareve dhe stafit të Përfaqësueses A. Kjo është hera e parë që është formuar Kosova A te femrat dhe për herë të parë do të luajë në arenën evropiane. "Shpresojmë në rezultat pozitiv. Rezultati nuk është aq i rëndësishëm sa është e rëndësishme paraqitja dhe kultura që duhet të tregojmë sa përfaqësojmë Kosovën. Nuk e përfaqësojmë vetëm veten, por kemi obligim më të madh se aq. Në jetën tonë bëjmë çfarë të duam, por kur kemi përfaqësim ndërkombëtar, duhet të jemi shumë më të kujdesshëm. Jam i lumtur që keni trajnerët më të mirë në basketbollin femëror. Edhe trajnerët janë të lumtur që në Federatë (FBK) ka persona që

e përkrahim basketbollin. Ne të gjithë më herët kemi luajtur basketboll, të gjithë e dimë se çka është basketbolli dhe cilat janë nevojat tuaja për të arritur rezultate sa më të mira", ka shtuar kryetari i FBK-së. Besimi është i madh te ky ekip për suksese. "Po ju tregoj se kemi më shumë besim në këtë përfaqësuese se në shumë përfaqësuese të tjera më herët, duke marrë parasysh punën, motivin dhe angazhimin. Ju dëshiroj shumë fat", deklaroi Arben Fetahu. Kosova do të garojë në Kampionatin Evropian për Shtete të Vogla në Qipro nga 20 deri më 25 Korrik. Vashat dardane janë në grup me Luksemburgun dhe Qipron.

Lilaj largohet nga Prishtina, shkon në Izrael

PRISHTINË, 1 KORRIK - Mesfushori nga Korça, Sabjen Lilaj, është larguar edhe zyrtarisht nga skuadra e Prishtinës. Ai karrierën do ta vijojë në Izrael me

skuadrën e Hapel Ramat, Gan Givatajim. Lajmi është bërë me dije nga klubi izraelit, por Lilaj do të largohet nga Prishtina pas ndeshjeve të Ligës së

Kampionëve kundër Ferencvarosh. "Mirë se erdhe Sabien Lilaj! Mesfushori shqiptar ka nënshkruar kontratë dyvjeçare me skuadrën. Lilaj ka fituar

gjashtë tituj në kampionatin shqiptar dhe, së fundmi, ka shtuar një titull pasi ka fituar Superligën e Kosovës në edicionin 2020/21", thuhet në njoftimin e klubit izraelit.



Kryeziu nënkruan kontratë trevjeçare me Prishtinën

PRISHTINË, 1 KORRIK - Leotrim Kryeziu është lojtar i Prishtinës. Sulmuesi i cili ishte në pronësi të Luganos në Zvicër dhe luajti te Prishtina si i huazuar, ka vendosur të qëndrojë në kryeqytet. 22-vjeçari ishte një

nga lojtarët më të mirë të Prishtinës në sezonin e shkuar dhe dha kontribut të madh në fitimin e titullit kampion. Ai ishte protagonist edhe në dy fitoret e fundit në miniturneun paraeliminator të Ligës së

Kampionëve. Prishtina ka zyrtarizuar marrëveshjen me talentin "dardan" i cili ka firmosur për tre vjet. Kontrata me Luganon i përfundonte në verën e vitit 2022, por Prishtina ka gjetur akord me zvicëranët

dhe ka siguruar shërbimet e bomberit. "Nga huazimi, Prishtina e transferon Leotrim Kryeziun nga Lugano. Për tri vitet e ardhshme skuadra siguron vijën e sulmit", thuhet në njoftimin e skuadrës prishtinase.



KF Drenica mbetet pa kryetar, largohet Veliqi

"Epoka e re"

SKENDERAJ, 1 KORRIK - Ilir Veliqi nuk do të jetë më kryetar i KF Drenica nga Skenderaj. Veliqi ka bërë me dije se largohet nga skuadra kuqezi për arsyeje personale, ndërsa ka falënderuar drejtuesit e Komunës së Skenderajt dhe Departamentin për Kulturë, Rini dhe Sport për bashkëpunimin korrekt. "Nuk do të jem kryetar i Klubit të Futbollit 'Drenica' për arsye personale. Falënderoj përzemërsisht për bashkëpunimin e sinqertë dhe korrekt kryetarin e komunës, Bekim Jashari, nënkryetarin Nuredin Lushtaku, DKRS-në, të cilëve u jam mirënjohës për angazhimin dhe kontributin e dhënë, në mbështetjen dhe përmbushjen e obligimeve dhe detyrave për një menaxhim të suksesshëm", ka thënë Veliqi. "Falënderoj të gjithë ata që gjatë



kësaj kohe punuan bashkërisht me mua dhe ishin korrektë në punën tonë të përbashkët në menaxhimin e klubit: kryesinë e klubit, shtabin teknik, lojtarët, punëtorët teknikë, donatorët, tifozët 'Shqiponjat e zeza' dhe të gjithë qytetarët e komunës tonë të cilët ishin përkrahës të

mëdhenj edhe në kohën më të vështirë kur gjendej klubi. Si rezultat i këtij bashkëpunimi dhe përkrahje të përbashkët, arritëm t'i tejkalojmë të gjitha sfidat. Udhëheqjes së re dhe KF Drenica i dëshirojmë shumë suksese në kampionatin në vazhdim", ka shtuar Veliqi.

Phoenixi kualifikohet në finale

PHOENIX, 1 KORRIK - Phoenix Suns dhe Chris Paul fluturojnë në finalen e madhe të NBA-së. Skuadra nga Arizona dominoi Los Angeles Clippersin në sfidën e gjashtë me rezultatin e thellë 130-103, duke e mbyllur serinë në shifrat 4-2. Suns në këtë mënyrë shfrytëzoi "match-ball"-in e dytë, duke triumfuar pikërisht në shtëpinë e kalifornianëve në prani të rreth 18 500 tifozëve. Për herë të parë në mijëvjeçarin e ri, Suns arrin në finalen e NBA-së, ku do të përplasjet me fituesin e çiftit Milwaukee Bucks-Atlanta Hawks. Për herë të fundit luftoi për unazën e NBA-së në vitin 1993, udhëhequr nga Charles Barkley, MVP i sezonit të rregullt, por që nuk mundi të bënte më shumë për ta arritur suksesin përfundimtar kundër legjendës Michael Jordan të Chicago Bullsit, raporton "Supersport". Lojtari më i mirë i përbashkët së "Staples Center" ishte pa dyshim Chris Paul, me veteranin e Sunsit që shënoi plot 41 pikë. Sikurse ka ndodhur edhe në përplasjet e mëparshme, perioda e parë u zhvillua në ekuilibër të plotë, edhe pse në një moment Suns shkoi +8 pikë. Ndërkohë, pjesa e parë u mbyll me një epërsi të



skuadrës nga Arizona, 57-66. Pas pushimit Suns i ruajti tendencën pozitive duke e thelluar gjithnjë e më shumë diferencën, por në periodën e tretë Clippers provoi përmbysjen me Paul George dhe DeMarcus Cousins, duke e ngushtuar në 7 pikë hendekun, por miqtë nga Arizona ishin të

papërmbytshëm në periodën e fundit duke e mbyllur ndeshjen me plus 27 pikë. Përveçse loja e Chris Paulit, për Suns vlen të përmendet kontributi i DeAndre Ayton me "double-double", 16 pikë e 17 "rebounde". Devin Booker e mbylli takimin me 22 pikë, ndërsa Joe Crowder me 19 pikë.

SHKURT

Fiorentina nuk rinovon kontratën me Riberyn

Pas dy sezonesh, Franck Ribery nuk do të jetë më lojtar i Fiorentinës. Ky lajm po qarkullonte prej kohësh, por tashmë është zyrtarë dhe këtë e ka bërë publike klubi i Fiorentinës me anë të një komunikate zyrtare ku falënderon ish-sulmuesin e Bayern Munchenit për aventurën me fanellën e skuadrës nga Firenze. 38-vjeçari aktualisht është lojtar i lirë dhe mund t'i bashkohet çdo skuadre të mundshme. Francezi me skuadrën vjollcë gjatë sezonit të kaluar u aktivizua në total në të gjitha kompeticionet në 30 ndeshje nga ku realizoi dhe 2 gola.

Dortmundi e konfirmon kalimin e Sanchos në Unitedin për 85 milionë euro

Borussia Dortmundi ka njoftuar se ka arritur marrëveshje me Manchester Unitedin në vlerë prej 85 milionë eurosh për shitjen e anësorit Jadon Sancho në "Old Trafford". Në një komunikatë për media, Dortmundi njoftoi: "Lojtari Jadon Sancho do të kalojë nga Borussia Dortmund GmbH & Co. KGaA në Manchester United Football Club Limited. Të dy klubet dhe lojtari arritën marrëveshje për këtë sot. Manchester Unitedi do t'ia paguajë BVB-së një shumë fikse prej 85 milionë eurove, nëse realizohet transferimi".

Young dhe Padelli largohen nga Interi


Skuadra e Interit ka konfirmuar largimin e mbrojtësit Ashley Young dhe portierit Daniel Padelli. "Nerazzurët" kanë vazhduar ndryshimet në skuadër para nisjes së sezonit të ri 2021/22. Pas arritjes së marrëveshjes për shitjen e Achraf Hakimi te Paris Saint-Germain, Interi ka konfirmuar edhe largimin e dy lojtarëve të tjerë. "Ne i japim lamtumirën Ashley Young dhe Daniele Padelli. Ishte një nder dhe një kënaqësi të festonim 'Scudetton' me ju. Faleminderit dhe fatin më të mirë për fazën tjetër të karrierës tuaj!", thuhet në njoftimin e Interit.

Hamilton siguron një kontratë dyvjeçare

Mercedesi dhe piloti britanik Lewis Hamilton janë pranë nënshkrimit të një marrëveshjeje për ta zgjatur kontratën edhe për dy sezone të tjera, lajm që konfirmohet nga "Daily Mail". "Uroj që kontrata e re me Lewis të jetë dyvjeçare, pasi nuk dua që të kaloj Krishtlindje si ato të vjetshmet, pa një kontratë me pilotët", ka thënë Toto Wolff, drejtor sportiv i Mercedesit. Pritet që marrëveshja të zyrtarizohet brenda korrikut para se të nisin pushimet verore. Mësohet se nga kontrata e re, piloti 7 herë kampion bote në Formula 1 do të arkëtojë 30 milionë sterlina në sezon. Kjo është një shumë më e vogël krahasuar me vitet e fundit. Zyrtarizimi i kontratës ka lidhje edhe me shokun e skuadrës që do të ketë Hamiltoni vitin tjetër. Ai ka kërkuar që të qëndrojë Valtteri Bottas, duke e cilësuar si shokun më të mirë të skuadrës që ka pasur ndonjëherë.

Serena Williams: Moment i vështirë, nuk doja të largohesha kështu

Tërheqja që në setin e parë të raundit të parë të grand slam të Wimbledonit ka lënë një shije të hidhur te tenistja 39-vjeçare amerikane Serena Williams. Prej disa vjetësh ajo është në kërkim të triumfit numër 24 në një grand slam, por kjo gjë duket si një mallkim për "panterën e zezë". "Mu këput zemra nga fakti që u dëmtova në këmbën e djathtë dhe isha e detyruar të tërhiqesha. Dashuria dhe respekti im shkon për të gjithë tifozët, që më mbështetën në atë çast e duartrokitën për mua, duke ndier një emocion të madh", ka thënë Serena Williams. "Nuk doja absolutisht të largohesha në këtë mënyrë nga ky turne, por sporti ka edhe momente të tilla të vështira që duhen përballuar", ka shtuar tenistja amerikane. Ajo ka konfirmuar se nuk do të luajë në Lojërat Olimpikë dhe do të përgatitet për grand slam të US Open, që nis në gusht.



Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "MELLON SOLUTIONS DOOEL KOSOVO BRANCH" ka marrë vendim të shuaj biznesin me nr. Unik: 810829591 si dhe me nr. të TVSH-së, 330240850 ku ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "MELLON SOLUTIONS DOOEL KOSOVO BRANCH" donelo odluku o prestani rada sa nr. Unik: 810829591, nr. TVSH 330240850 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "MELLON SOLUTIONS DOOEL KOSOVO BRANCH" has come to the decision to quit its nr. Unik: 810829591, nr. TVSH 330240850 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Altina Tahiri shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Migjeni"
- ▶ Bleona Ferizi shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Azem Bejta"
- ▶ Haxhere Avdiu shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT "Anton Ceta"
- ▶ Florian Mulaj shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Fazli Greicevci"
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.23-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokal me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT**SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

